

VENDIM
Nr. 224, datë 17.4.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SUEDISË, LIDHUR
ME FAZËN E TRETË TË PROGRAMIT PËR FORCIMIN E POLICIMIT NË
KOMUNITET NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, lidhur me fazën e tretë të programit për forcimin e policimit në komunitet në Shqipëri, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MARRËVESHJE GRANTI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
SUEDISË, LIDHUR ME FAZËN E TRETË TË PROGRAMIT PËR FORCIMIN E
POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI

Kontributi i SIDA-s nr. 15636

Versioni 1.2 i nëntorit 2024

Përmbajtja

1. Objekti dhe Informacion mbi Historikun
2. Objektivat e Programit
3. Zbatimi
4. Granti
5. Disbursimet
6. Menaxhimi financiar
7. Raportimi financiar
8. Raportimi narrativ
9. Prokurimi
10. Monitorimi
11. Takimet vjetore
12. Vlerësimet
13. Auditimet
14. Shlyerja e interesit, fitimet nga këmbimi dhe fondet e papërdorura
15. Korrupsioni dhe parregullsi të tjera
16. Shfrytëzimi seksual, abuzimi seksual dhe ngacmimi seksual
17. Rregullimet ligjore
18. Vizibiliteti dhe informacioni
19. Referimi në marrëveshje të tjera

20. Përfundimi
21. Periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes
22. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
23. Njoftime

Kjo Marrëveshje Granti (Marrëveshja) është lidhur ndërmjet

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Brendshme (“Përfituesi”);

dhe

2. Suedisë, të përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim, SIDA (“Suedi”) për Programin “Faza e tretë – Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri”, të referuara bashkërisht si Palët.

1. Objekti dhe informacion mbi historikun

1.1 Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë i ka kërkuar Suedisë të kontribuojë në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Sigurinë në Komunitet 2021–2026 nëpërmjet financimit të fazës së tretë të Programit për Forcimin e Policimit në Komunitet në Shqipëri” (Projekti/Programi).

1.2 Financimi i Programit nga Përfituesi pasqyrohet në buxhetin e shtetit të Përfituesit.

1.3 Suedia ka vendosur të japë një grant prej 36 MSEK që do të përdoret ekskluzivisht për zbatimin e Programit gjatë periudhës nga data 20 korrik 2024 deri më 19 qershor 2029 (Periudha e Aktivitetit). Financimi suedez do të përdoret plotësisht për prokurimin e një partneri që do të zbatojë Programin.

1.4 Palët kanë rënë dakord të lidhin një Marrëveshje, e cila përbëhet nga këto Kushte Specifike dhe anekset e mëposhtme, të cilat të gjitha janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe janë renditur sipas prioritetit. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet Kushteve Specifike dhe anekseve, Kushtet Specifike do të kenë përparësi.

Anekset

A. Dokumenti i Programit

1.5 Palët do të bashkëpunojnë dhe do të komunikojnë rregullisht me njëra-tjetrën për të gjitha çështjet që lidhen me zbatimin e Programit dhe kësaj Marrëveshjeje. Palët do të informojnë pa vonesë njëra-tjetrën për çdo rrethanë që mund të ndërhyjë ose rrezikon të ndërhyjë në zbatimin e suksesshëm të Programit dhe ndryshime të tjera, me qëllim zgjidhjen e çështjes. Palët do të mbajnë takime nëse, ose kur kërkohet nga secila palë.

2. Objektivat e Programit

2.1 Objektivi i përgjithshëm i Programit është “Përmirësimi i besimit dhe partneritetit ndërmjet policisë dhe komunitetit, kontribuon në fqinjësi më të sigurt”, siç përshkruhet në dokumentin e programit të titulluar “Propozimi i programit: Faza e tretë - Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri” (SCPA 3), duke përfshirë buxhetin në monedhën euro, datë 17.7.2023 (Dokumenti i Programit), shtojca A.

2.2 Dokumenti i Programit, si dhe buxheti do të përditësohen me ndryshime me shkrim, sa herë që kërkohen ndryshime të rëndësishme në Kuadrin e Rezultateve të Projektit/Programit për zbatimin efektiv, duke marrë parasysh performancën buxhetore, stabilitetin e burimeve njerëzore në Policinë e Shtetit shqiptar, si përfitues i drejtpërdrejtë, dhe programe të reja të mundshme ndërkombëtare që kontribuojnë në të njëjtat fusha si SCPA 3. Ndryshimet e kërkuara do të paraqiten për miratim te SIDA/Ambasada Suedeze, pasi të diskutohen ndërmjet Policisë së Shtetit shqiptar (PSH) (përfituesi kryesor) dhe konsulentit zbatues (partneri bashkëpunues), dhe miratohen në Komitetin Drejtues të Programit.

3. Zbatimi

3.1 Si financuese, Suedia nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi dhe/ose detyrim ndaj asnjë pale të tretë, në lidhje me zbatimin e Projektit/Programit, përveç konsulentit zbatues.

3.2 Përfituesi ka autorizuar Ministrinë e Brendshme që të jetë përgjegjëse ndaj Përfituesit për zbatimin e Projektit/Programit.

4. Granti

4.1 Suedia merr përsipër të financojë Programin, duke prokuruar një partner/konsulent zbatimi deri në një shumë maksimale prej 36 000 000 SEK (tridhjetë e gjashtë milionë korona suedeze) (Granti), në bazë të caktimit të kësaj shume nga parlamenti suedez.

4.2 Granti do të përdoret vetëm për të financuar kostot aktuale të zbatimit të Programit gjatë periudhës së aktivitetit.

4.3 Përfituesi është përgjegjës për të siguruar çdo burim shtesë që mund të kërkohet për zbatimin e duhur të Projektit/Programit. Kjo duhet të pasqyrohet në buxhet dhe të përfshihet në raportim. Në përputhje me Marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Suedisë mbi Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme të Bashkëpunimit për Zhvillim, të ratifikuar me ligjin nr. 9608, datë 18.9.2006, fondet e financuara në kuadër të këtij Projekti nuk do të përdoren për të paguar tatimin mbi vlerën e shtuar.

5. Disbursimet

5.1 Granti do të disbursohet me pagesën e faturave nga konsulenti zbatues i prokuruar, bazuar në shpenzimet e Programit.

6. Menaxhimi financiar

E pazbatueshme

7. Raportimi financiar

7.1 Konsulenti zbatues do t'i sigurojë Suedisë dhe Ministrisë së Brendshme pasqyrat financiare gjashtëmujore dhe raportet financiare që do të përfshijnë informacion mbi shumën e marrë. Raporti do të përfshijë, gjithashtu, informacion mbi shpenzimet totale, të zbërthyer/të analizuara, në përputhje me zërat e buxhetit të rënë dakord, për periudhën raportuese, si dhe shumatat e akumuluar për të gjithë periudhën e Programit.

8. Raportimi narrativ

8.1 Përfituesi dhe Suedia do të marrin me shkrim një raport narrativ/gjashtëmujor nga konsulenti zbatues çdo vit.

8.2 Raporti narrativ do të përmbajë një analizë të progresit të aktiviteteve të Programit dhe rezultateve të pritshme, duke ndjekur strukturën e Dokumentit të Programit, siç është përpunuar më tej në planet vjetore të punës.

8.3 Raportet do të mbulojnë periudhat përkatëse gjashtëmujore nga fillimi i Programit. Raporti gjashtëmujor do të përmbajë përshkrim, mbi baza kumulative, i cili mbulon të gjithë periudhën e Programit, për sa u përket:

- aktiviteteve të realizuara gjatë periudhës së raportimit;
- rezultateve të arritura në krahasim me rezultatet e planifikuara;
- rezultatit/eve të objektivit/objektivave të arritur të krahasuar me objektivin/objektivat e rezultateve të planifikuara (ose progresin drejt arritjes së objektivit/objektivave të rezultateve dhe një vlerësim të mundësisë për arritjen e objektivave të rezultateve të planifikuara;
- një vlerësim të faktorëve të riskut që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave; dhe
- një vlerësim të përshtatjeve/rregullimeve të mundshme në zbatimin e Programit, duke përfshirë menaxhimin e riskut.

Përfituesi do ta bëjë publik të njëjtin informacion ndaj grupit të synuar, me qëllim që të rrisë transparencën përmes (ndër të tjera) takimit vjetor për të provuar progresin e Programit, për të debatuar dhe për të diskutuar çështjet e zhvillimit të sigurisë dhe drejtësisë, për të marrë reagime nga përfituesit e Programit dhe për të identifikuar prioritetet e ardhshme të Programit.

Përfituesi dhe Suedia do të marrin me shkrim një raport përfundimtar për përfundimin e Programit. Raporti përfundimtar do të përmbajë përshkrim, mbi baza kumulative, i cili mbulon të gjithë periudhën e aktivitetit, për:

- rezultatet e arritura në krahasim me rezultatet e planifikuara;

- objektivin/objektivat e rezultateve të arritura në krahasim me objektivin/objektivat e rezultateve të planifikuara;
- një vlerësim të faktorëve që kanë ndikuar në arritjen e objektivave;
- mësimet e nxjerra nga zbatimi i Programit/Projektit; dhe
- një vlerësim të nevojave të mundshme për rregullime në Program, duke përfshirë veprimet që lehtësojnë riskun.

Përfituesi do të bëjë publik të njëjtin informacion për grupin e synuar, në mënyrë që të rrisë transparencën përmes një seminari/eventi përmbyllës ku rezultatet dhe trashëgimia e Programit do të prezantohen dhe ndahen me palët e interesuara dhe publikun.

8.4 Përfituesi do t'i ofrojë Suedisë çdo informacion të rëndësishëm për zbatimin e Programit, siç mund të kërkohej nga Suedia.

9. Prokurimi

9.1 Nuk do të ketë asnjë prokurim me financim të Programit që do të kryhet nga Përfituesi gjatë zbatimit të Projektit/Programit. Konsulenti Zbatues që do të prokurohet nga Suedia, do të kryejë të gjitha prokurimet që do të kërkohej për Programin dhe në përfitim të Përfituesit. Konsulenti Zbatues do të kryejë prokurimet në përputhje me planin e prokurimit të rënë dakord dhe me procedurat e veta dhe legjislacionin kombëtar të prokurimit në Suedi. Plani i prokurimit do të përfshijë detaje për çdo prokurim, duke përfshirë procedurat e dakordësuara për konsultime me Përfituesin.

9.2 Përfituesi do të sigurojë përfaqësues në Komitetin e Vlerësimit të tenderit që do të zhvillohet nga Suedia për prokurimin e Konsulentit Zbatues të Programit (SCPA 3).

10. Monitorimi

10.1 Përfituesi është përgjegjës për monitorimin e progresit dhe performancës së Programit dhe arritjen e rezultateve të pritshme të tij.

10.2 Suedia do të monitorojë përputhshmërinë dhe performancën bazuar në këtë Marrëveshje.

10.3 Procesi i vlerësimit të ecurisë së zbatimit të Programit do të përshtatet me procesin e rishikimit të Përfituesit dhe do të bëhet kryesisht përmes mbledhjeve të Komitetit Drejtues të Programit që do të mbahen dy herë në vit në lidhje me raportimin e progresit (narrativ dhe financiar).

10.4 Përfituesi dhe Suedia do të mbajnë një dialog të ngushtë në lidhje me mbështetjen dhe zbatimin e Programit.

11. Takimet vjetore

11.1 Palët do të takohen çdo gjashtë muaj për të diskutuar zbatimin e Programit. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga Përfituesi nëpërmjet Policisë së Shtetit shqiptar. Takimi i Komitetit Drejtues të Programit do të shërbejë si takimi kryesor ndërmjet palëve. Çdo takim shtesë i nevojshëm për të diskutuar çështje të veçanta mund të organizohet me iniciativën e njëres prej palëve.

11.2 Misionet dhe takimet do të planifikohen në mënyrë që procesi i buxhetit të Programit të lehtësohet dhe që nevoja për kontribut në dialogun e politikave dhe proceset e vendimmarrjes, të akomodohen aq sa është e mundur.

11.3 Kostoja e takimeve do të mbulohet nga buxheti i Programit.

11.4 Temat kryesore që do të diskutohen gjatë konsultimeve, përfshijnë ecurinë e zbatimit të Programit, zhvillimin e lidhur me kontekstin politik dhe ekonomik të Programit, devijimet nga plani dhe arsyet, si edhe masat zbutëse, bashkëpunimin me programet e tjera të asistencës ndërkombëtare, komunikimin ndërmjet palëve të bashkëpunimit programor, evente vjetore për komunikim me palët e jashtme dhe publikun etj.

11.5 Rezultatet e takimit do të regjistrohen në procesverbalin e dakordësuar. Procesverbali i rënë dakord do të hartohet nga Konsulenti Zbatues dhe një draft do t'i dorëzohet Suedisë për miratim dhe komente, brenda dy javëve pas takimit. Suedia do të informojë Përfituesin për miratimin dhe komentet e saj brenda 10 ditëve nga marrja e draftit.

11.6 Mbledhje shtesë konsultative mund të kërkohen nga Përfituesi ose Suedia për çdo temë që lidhet me zbatimin e Projektit/Programit.

12. Vlerësimet

12.1 Nëse njëra Palë kryen ose porosit një vlerësim gjatë Programit, ajo duhet të informojë Palën tjetër paraprakisht dhe t'i sigurojë Palës tjetër një kopje të raportit të vlerësimit. Suedia mund të kryejë një rishikim afatmesëm të Programit, nëse është e nevojshme.

12.2 Nëse Suedia kryen një mision vlerësimi ose monitorimi, Përfituesi do të marrë përsipër të ofrojë çdo dokument ose informacion që do të ndihmojë në misionin e vlerësimit ose monitorimit dhe t'i japë të drejtat e aksesit, siç përshkruhet në këtë Marrëveshje.

12.3 Kostoja e një vlerësimi të kërkuar ose të porositur nga Suedia, do të mbulohet nga Suedia.

13. Auditimet

E pazbatueshme.

14. Shlyerja e interesit, fitimet nga këmbimi dhe fondet e papërdorura

E pazbatueshme.

15. Korrupsioni dhe parregullsia të tjera

15.1 Palët do të punojnë në mënyrë aktive për të parandaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera brenda Programit. Ky detyrim zbatohet për të gjithë anëtarët e stafit, konsulentët dhe personelin tjetër jo staf.

15.2 Korrupsioni dhe parregullsitë e tjera i referohen të gjitha llojeve të:

- a) korrupsionit, duke përfshirë ryshfetin, nepotizmin, shpërblime të paligjshme ose forma të tjera të shpërdorimit të besimit, pushtetit dhe pozitës për përfitime të parregullta;
- b) shpërdorimit të parave të gatshme, inventarit dhe të gjitha llojeve të asetëve;
- c) deklaratave mashtruese financiare dhe jofinanciare;
- d) çdo përdorimi tjetër të fondeve që nuk është në përputhje me planin e punës dhe me buxhetin.

15.3 Palët do të:

- a) marrin parasysh rrezikun e korrupsionit dhe parregullsitë e tjera gjatë planifikimit dhe zbatimit të Programit dhe të identifikojnë rreziqet kryesore dhe masat për uljen e rrezikut. Nëse identifikohet një rrezik i konsiderueshëm i korrupsionit dhe i parregullsive të tjera, do të miratohen masa për uljen e rrezikut të identifikuar;
- b) organizojnë funksionimin e tyre dhe sistemet e kontrollit të brendshëm, në mënyrë që korrupsioni dhe parregullsitë e tjera të parandalohen, menaxhohen dhe zbulohen;
- c) bëjnë përpjekje maksimale për të parandaluar dhe për të ndaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera brenda Programit; dhe
- d) kërkojnë që i gjithë personeli i përfshirë dhe çdo konsulent, furnizues dhe kontraktor i financuar nga Programi të shmangin korrupsionin dhe parregullsitë e tjera.

15.4 Përfituesi do të informojë Suedinë menjëherë për çdo tregues të korrupsionit dhe të parregullsive të tjera në ose në lidhje me Projektin/Programin.

15.5 Përfituesi merr përsipër të hetojë praninë e korrupsionit dhe parregullsitë e tjera dhe të ndërmarrë veprime, duke përfshirë veprimet ligjore, ndaj personave që ka arsye të dyshohen për korrupsion dhe parregullsi të tjera. Palët do të konsultohen vazhdimisht me njëra-tjetrën për trajtimin e mëtejshëm të çështjes.

16. Shfrytëzimi seksual, abuzimi seksual dhe ngacmimi seksual

16.1 Palët janë të përkushtuara për të parandaluar dhe reaguar në mënyrë aktive ndaj shfrytëzimit seksual, abuzimit dhe ngacmimit seksual (SEAH), siç përcaktohet më poshtë. Ky detyrim zbatohet për të gjithë anëtarët e stafit, konsulentët dhe personelin tjetër që nuk është pjesë e brendshme e stafit.

16.2 Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

- a) “Shfrytëzimi seksual”, çdo abuzim aktual ose i synuar i një pozite vulnerabiliteti ose pozite pushteti, varësie ose besimi, për qëllime seksuale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në përfitimin monetar, social ose politik nga shfrytëzimi seksual i një tjetri.

b) “Abuzimi seksual”, ndërhyrja fizike aktuale ose e kërcënuar e një natyre seksuale, qoftë me forcë ose në kushte të pabarabarta ose shtrënguese.

c) “Ngacmimi seksual”, çdo formë e sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale, me qëllim ose efekt shkeljen e dinjitetit të një personi.

16.3 Palët do të marrin parasysh rrezikun e SEAH-së, kur planifikojnë dhe zbatojnë Programin dhe identifikojnë rreziqet kryesore dhe masat për uljen e rrezikut.

16.4 Përfituesi do të informojë menjëherë Suedinë për çdo tregues të SEAH-së në ose në lidhje me Projektin/Programin.

16.5 Përfituesi merr përsipër të hetojë praninë e SEAH-s dhe të ndërmarrë veprime, përfshirë veprimet ligjore, kundër personave për të cilët ka arsye të dyshohet për SEAH-në.

17. Rregullimet ligjore

17.1 Në rast mospërputhjeje nga ana e Përfituesit me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, Suedia rezervon të drejtën për të ushtruar mjetet juridike të mëposhtme, duke përfshirë mbajtjen në burim të disbursimeve të mëtejshme dhe/ose reduktimin e disbursimeve të reja, kërkimin e shlyerjes së fondeve ose përfundimin e mbështetjes së saj për Programin.

17.2 Në rast të shkeljes së Marrëveshjes, Suedia mund ta ndërpresë Marrëveshjen me njoftim dy muaj përpara.

17.3 Në rast të shkeljes së rëndë të Marrëveshjes, Suedia mund ta ndërpresë Marrëveshjen me efekt të menjëhershëm.

17.4 Në rastet e përfundimit nga Suedia, përfundimi nuk do të zbatohet për fondet e dedikuara në mënyrë të pakthyeshme në mirëbesim nga Përfituesi ndaj palëve të treta përpara datës së njoftimit të përfundimit, me kusht që angazhimet të jenë bërë në përputhje me këtë Marrëveshje.

17.5 Çdo ndërprerje do të bëhet me njoftim me shkrim për përfundimin.

18. Vizibiliteti dhe informacioni

18.1 Kur u referohet aktiviteteve, të financuara plotësisht ose pjesërisht në përputhje me këtë Marrëveshje, Përfituesi gjithmonë do të njohë dhe do të bëjë publike që aktivitetet të financohen përmes ndihmës suedeze për zhvillim.

18.2 Logoja tip e Suedisë do të përdoret në prodhimin e materialeve informative dhe në lidhje me aktivitetet informative.

18.3 Prodhimi i materialeve të tilla është plotësisht përgjegjësi e Përfituesit dhe përgjegjësia e përmbajtjes i takon botuesit. “SIDA” ose “Suedia” nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë që mund të perceptohet sikur SIDA ose Suedia të kenë marrë pjesë në prodhim ose të mbështesin ndonjë opinion të paraqitur.

18.4 SIDA dhe departamentet e tjera të administratës suedeze jashtë vendit rezervojnë të drejtën për të kopjuar dhe shpërndarë materiale të tilla, nëse kërkohet.

19. Referimi në marrëveshje të tjera

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve, sipas kësaj Marrëveshjeje, rregullohet gjithashtu nga:

- Marrëveshja mbi Termat dhe Kushtet e Përgjithshme për Bashkëpunimin Zhvillimor ndërmjet Palëve për periudhën nga data 30 qershor 2006 deri në njoftimin e përfundimit nga njëra nga palët;

- çdo marrëveshje që mund të zëvendësojë ose ndryshojë marrëveshjet në fjalë.

20. Përfundimi

20.1 Kjo Marrëveshje do të mbetet e vlefshme nëse nuk përfundon paraprakisht me njoftim me shkrim gjashtë muaj përpara nga secila palë.

21. Periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes

21.1 Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me të cilin palët njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave ligjore të parashikuara në legjislacionin e tyre kombëtar për hyrjen në fuqi dhe do të mbetet e vlefshme deri më 31 dhjetor 2029, përveç nëse ndërpritet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ose deri në kthimin e çdo fondi të papërdorur në Suedi dhe përmbushjen e

kërkesave për raportimin, në lidhje me këtë Marrëveshjeje, kohë në të cilën kjo Marrëveshje skadon.

21.2 Përfundimi ose skadimi i Marrëveshjes nuk i çliron Palët nga asnjë përgjegjësi që rrjedh nga ndonjë veprim ose mosveprim që ka ndodhur përpara përfundimit ose skadimit të tillë.

22. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet Palëve, në lidhje me interpretimin, aplikimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, ato do të konsultohen me njëra-tjetrën për të arritur një zgjidhje me mirëkuptim.

23. Njoftime

Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë me shkrim, duke specifikuar numrin e kontributit dhe titullin e Programit dhe të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Përfituesin: Daniela Çekani, daniela.cekani@mb.gov.al

Drejtores e Drejtorisë së Projekteve në Ministrinë e Brendshme

Për Suedinë

Linda Gjermani, linda.gjermani@gov.se

Në vëmendje të Seksionit për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Zyrtare e Programit Linda Gjermani, linda.gjermani@gov.se

Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar, SIDA/Ambasada e Suedisë në Tiranë.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në gjuhën angleze në dy origjinale, një për secilën palë.

Vendi dhe data

Për Këshillin e Ministrave të Republikës
së Shqipërisë të përfaqësuar nga
Ministria e Brendshme

Vendi dhe data

Suedi, përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për
Bashkëpunim dhe Zhvillim
Ndërkombëtar (SIDA)
Erik Illes, Këshilltar,
Përgjegjës i Seksionit për
Bashkëpunimin për Zhvillim

PROPOZIMI PËR PROGRAMIN: FAZA E TRETË FUQIZIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET NË SHQIPËRI

Hyrje

Qysh nga viti 2012, Suedia po e mbështet Ministrinë shqiptare të Punëve të Brendshme dhe Policinë e Shtetit të fuqizojnë policimin e tyre në komunitet nëpërmjet dy fazave të një Programi. Faza e dytë e Programit për Fuqizimin e Policimit në Komunitet në Shqipëri (FPKS) përfundoi në fund të vitit 2022. Ministria e Punëve të Brendshme i ka kërkuar Suedisë të vazhdojë mbështetjen dhe ta konsolidojë atë, duke u mbështetur në suksesin e fazave të mëparshme. DCAF ISSAT-i ka punuar me aktorët kryesorë shqiptarë për të kuptuar gjendjen e tashme të zbatimit të koncepteve të policimit në komunitet, përditësuar Projektin e Programit dhe për t'ia përshtatur kontekstit të tashëm dhe për të identifikuar qasjen e duhur për zgjatjen. Procesi i hartimit për Fazën e Tretë vlerësoi informacionin, në lidhje me gjendjen e tashme të reformave brenda të tri shtyllave, identifikoi dhe vleftësoi nevojat dhe prioritetet e partnerëve të ndryshëm të Projektit, në lidhje me këto fusha të zbatimit, dhe nga kjo analizë paraqiti dokumentin për propozimin e Projektit për të orientuar ekipin zbatues të Fazës së Tretë.

Propozimi i paraqitur është i organizuar sipas të tria shtyllave të njëjta të përdorura gjatë Fazës së Dytë, pasi vizita vlerësuese pa me vend rëndësinë dhe nevojën në vijim për mbështetje nga Programi në të gjitha këto drejtime. Secili seksion identifikon aspektet kryesore të zbatimit të Programit që janë komponentë të nevojshëm të Fazës së Tretë, pa të cilat Programi nuk mund të jetë i suksesshëm në mbështetjen e përmirësimeve të qëndrueshme. Këto tri shtylla janë: 1.

përmirësimi i efektivitetit të zbatimit të policimit në komunitet; 2. fuqizimi i përgjegjshmërisë dhe bashkërendimit polici–shtet, së bashku me aftësinë analitike të policimit në komunitet; 3. përmirësimi i reagimeve policore ndaj prioriteteve komunitare, duke përfshirë dhunën në familje. Siç ishte rasti me fazat e mëparshme, Programi do të ketë një komponent mbisektorial të grandeve të vogla, që do të përdoren për të përforcuar pjesëmarrjen dhe ndikimin e komunitetit mbi zhvillimin e qasjeve të policimit në komunitet.

Qëllimi i këtij dokumenti është ofrimi i një përshkrimi të hollësishëm të konceptit, strukturës dhe aktiviteteve kryesore të Programit në Fazën e Tretë të FPKS-së. Ky është rezultat i një procesi konsultimesh të zhvilluara me aktorët kryesorë, duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Policinë Shqiptare të Shtetit (PSS), Qeverinë e Shqipërisë (QS) dhe aktorët komunitarë shqiptarë, që kanë rënë dakord për drejtimit dhe sferat e punës. Ky dokument është hartuar për t'i ofruar Agjencisë Suedeze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Zhvillimin (SIDA) një bazë për shpalljen e tenderit për të formuar ekipin e Programit për menaxhimin e fazës së tretë të zbatimit.

Përmbajtja

Hyrje

Shkurtime

Konteksti i Reformës në Polici

Kontributi Reformues i Fazave të Mëparshme

Propozimi për Programin

Vizioni dhe Teoria e Ndryshimit

Përmirësimet në Policimin në Komunitet

Analiza dhe Përgjegjshmëria e Policimit në Komunitet

Kapacitet i Specializuar i Policisë për Prioritetet Komunitare

Skema e grandeve

Bashkëpunimi me Partnerët Ndërkombëtarë

Gjinia dhe të drejtat e njeriut

Profili dhe shtrirja e Programit

Projektbuxheti

Menaxhimi i Programit dhe qeverisja

Faza tranzitore dhe mbyllja e Programit

Risku

Përfundim

Aneksi A

Kuadri monitorues dhe udhëzuesi i treguesve

ANEKSI B

Matrica e menaxhimit të riskut

ANEKSI C

Lista e intervistave dhe vizitat e zhvilluara

ANEKSI D

Projektbuxheti në euro

Shkurtime

AKSHI

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

PSS

Policia e Shtetit Shqiptar

KVT

Kamera të vendosura në trup

OSC

Organizata të shoqërisë civile

DCAF ISSAT

Ekipi Këshillimor i Sektorit Ndërkombëtar të Sigurisë të Qendrës së

Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë

EU4LEA

Bashkimi Evropian për Zbatimin e Ligjit në Shqipëri

QSH

Qeveria e Shqipërisë

INSTAT	Instituti i Statistikave
KLSP	Këshillat Lokalë të Sigurisë Publike
RLP	Rreth Lokal i Policisë
SMSL	Sistemi i Matjes së Sigurisë Lokale
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MSMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MB	Ministria e Punëve të Brendshme
RAM	Rishikim Afatmesëm
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
EMP	Ekipi i Menaxhimit të Projektit
KDP	Komiteti Drejtues i Projektit
SAM	Spektori i Analizës dhe Monitorimit
ASPSKN	Agjencia Shtetërore për Programet Strategjike dhe Koordinimin e Ndihmës
FPKS	Programi i Fuqizimit të Policimit në Komunitet në Shqipëri
OSS	Oficeri i Sigurisë në Shkollë
SIDA	Agjencia e Bashkëpunimit Suedez Ndërkombëtar për Zhvillim
MB	Mbretëria e Bashkuar
PZKB	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

Konteksti i reformës në polici

Programi FPKS-ë përfiton nga një marrëdhënie e mirëvendosur ndërmjet aktorëve kryesorë të ministrisë dhe policisë, dhe nga një historik i provuar i mbështetjes së vazhdueshme. Si rrjedhim, ky gëzon një nivel të konsiderueshëm mbështetjeje nga drejtuesit e lartë të policisë dhe vlerësohet dhe njihet në të gjitha drejtoritë. Ka kufizime në masën në të cilën kuptohen qëllimi dhe detajet e disa përpjekjeve për reforma përtej vendndodhjeve të pilotimit, të cilat përfituan pjesën më të madhe të mbështetjes së Programit në Fazën e Dytë.

Procesi i projektimit po kryhet ndërkohë që edhe drejtori i përgjithshëm po planifikon të ristrukturojë forcën e policisë. Ky ristrukturim do të rezultojë në transferimin e një numri të konsiderueshëm të personelit të Policimit në Komunitet në ekipet e Hetimit të Krimit, krijimin e ekipeve të vogla të punonjësve të policimit në komunitet të fokusuar në ndërgjegjësimin në shkollë, si dhe në forcimin e modelit të policimit të zonës. Rezultati i këtyre ndryshimeve është refuzimi i një përjasjeje ndaj policimit në komunitet që fokusohet në modele të qarta dhe të veçanta të oficerëve të policimit në komunitet/të zbatimit të ligjit. Ai ka potencialin e zgjerimit të objektit të fokusuar në komunitet të një gamë më të gjerë oficerësh, por rrezikon të humbasë vëmendjen e fokusit në komunitet nëpërmjet ndryshimeve të projektuara për të forcuar aftësinë hetuese.

Kufizimet e menaxhimit aktual të burimeve njerëzore të policisë kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në udhëheqjen dhe menaxhimin e policisë. Shembulli më i qartë i kësaj mund të shihet në qasjet aktuale ndaj transferimit në nivelin e menaxhimit policor, që ndodhin shumë shpesh dhe nuk u japin menaxherëve kohë të mjaftueshme për të zhvilluar seksionet e tyre, rezultojnë në ndërprerje të konsiderueshme të proceseve të planifikimit dhe reformës dhe nuk janë në përputhje me ligjin aktual në lidhje me transferimin e personelit. Megjithatë, me gjithë ndikimin e konsiderueshëm të kësaj çështjeje në përmirësimet në policimin në komunitet, ka vullnet të kufizuar për ta trajtuar këtë çështje dhe realizimi i kësaj do të kërkonte një Program të përkushtuar mbështetjeje për reformën e menaxhimit të burimeve njerëzore brenda PSS-së.

Kontributi reformues i fazave të mëparshme

Suksesi i fazave të mëparshme të Programit FPKS-ë tregon se një filozofi e policimit në komunitet kuptohet nga PSS-ja në të gjithë Shqipërinë dhe se një numër i konsiderueshëm oficerësh janë trajnuar për këto qasje. Zbatimi i policimit në komunitet është më i plotë në zonat që kanë marrë mbështetjen më të madhe të Programit dhe garantohet një mbështetje më e gjerë

për të siguruar qëndrueshmëri të qasjes në të gjithë Shqipërinë. Shqetësimi në lidhje me korrupsionin e policisë mbetet i lartë dhe tendenca e fundit në besimin e komunitetit është e përzier, megjithëse kjo është në një kontekst të shqetësimeve përgjithësisht të larta të korrupsionit në të gjitha shërbimet qeveritare. Si e tillë, mbështetja në Fazën e Tretë të Programit duhet të trajtojë si qëndrueshmërinë e efektivitetit të qasjeve në qendër të komunitetit, ashtu edhe të mbështesë përpjekjet e orientuara nga brenda për të forcuar transparencën dhe përgjegjshmërinë e PSS-së ndaj komunitetit të cilit i shërbejnë.

Përpjekjet menaxheriale janë fokusuar në zhvillimin e marrëdhënieve ndërmjet policisë dhe autoriteteve vendore, që është një mekanizëm i arsyeshëm. Kjo aktualisht është zbatuar vetëm pjesërisht dhe ka një nivel të lartë të ndryshueshmërisë në nivelin e efektivitetit të Këshillave Lokale për Sigurinë Publike (KLSP). Si rezultat, duhet bërë shumë më tepër për të integruar komitetet në mënyrë të qëndrueshme dhe për të siguruar që roli dhe kompetencat e tyre të kuptohen mirë dhe të jenë të qëndrueshme në të gjitha qarqet. Mbështetja e Programit për policimin e orientuar nga të dhënat gjithashtu ka përparuar shumë, por është qartësisht më e avancuara në fushat e programeve pilot. Është bërë shumë më pak për menaxhimin e përgjithshëm të policisë, dhe duke pasur parasysh shtrirjen e çështjeve rreth Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, veçanërisht në nivelin drejtues dhe kjo ka shumë të ngjarë të mbetet jashtë objektit të fazës së tretë.

Për sa u përket kapaciteteve të specializuara policore për të adresuar çështjet e komunitetit, Programi ka mbështetur dukshëm përmirësimet në reagimin e policisë ndaj dhunës në familje, policimin e qarkullimit rrugor dhe mbrojtjen e të rinjve nëpërmjet programeve të ndërgjegjësimit të shkollave. Të tri fushat mbeten të rëndësishme për angazhimin e komunitetit dhe përmirësimet që janë arritur kanë nevojë për mbështetje të mëtejshme për të siguruar që ato të jenë njëtrajshmërisht efektive dhe të qëndrueshme.

Propozimi për Programin

Vizioni dhe teoria e ndryshimit

Qëllimi i Programit mbetet i njëjtë me atë të fazës së mëparshme:

Besimi dhe partneriteti i përmirësuar ndërmjet policisë dhe komunitetit i bën lagjet më të sigurta.

Kjo do të arrihet përmes një plani pesëvjeçar të mbështetjes që do të përfshihet në tri fusha kryesore të asistencës. Shtylla e parë fokusohet në konsolidimin dhe zgjerimin e përshtatjes së policimit në komunitet nga PSS-ja si një qasje. Shtylla e dytë vazhdon të zhvillojë një qasje të bazuar në të dhënat për policimin në komunitet në të gjithë PSS-në, ndërkohë që forcon lidhjet midis pjesëve të qeverisë me objekt garantimin e sigurisë publike. Duke bërë këtë, sigurohet që PSS-ja merr vendime mbi bazën e një kuptimi të qartë të prioritetëve të komunitetit dhe është në gjendje të shfrytëzojë të gjithë gamën e kapaciteteve të qeverisë në mbështetje të përmirësimit të sigurisë për komunitetin. Shtylla e fundit fokusohet në sigurimin që PSS-ja të ketë kapacitete adekuate në temat kyçe të policimit të posaçëm, në lidhje me dhunën në familje, qarkullimin rrugor dhe angazhimin e të rinjve. Kjo shtyllë siguron që reagimet e PSS-së ndaj prioritetëve të komunitetit të jenë të përshtatshme dhe të bazuara në një kuptim të qartë të çështjeve, nevojave të grupeve vulnerabël dhe që policia të ketë aftësitë e duhura për të reaguar në mënyrë adekuate.

Përmirësimet në Policimin në Komunitet

Fokusi kryesor i Programit të Fazës së Tretë do të vazhdojë të jetë miratimi dhe zbatimi i suksesshëm i parimeve dhe i praktikave të policisë me fokus komunitetin. Kjo do të përfshijë menaxhimin e çdo procesi të ndryshimit strukturor të PSS-së për të garantuar ruajtjen e përfitimeve në qasjet e policimit në komunitet, përmirësimin e qëndrueshmërisë së zbatimit të policimit në komunitet në të gjithë vendin, trajnimin e mëtejshëm të personelit në parimet e policimit në komunitet dhe përmirësimin e llogaridhënies së oficerëve në kontakt me Komuniteti.

Policia zbaton në mënyrë efektive qasjet e fokusuara në komunitet	
Oficerët angazhohen me komunitetet	Menaxhimi mbështet fokusimin në komunitet

Trajnim për Policimin në Komunitet	Përgjegjshmëria (kamerat e trupit dhe monitorimi)	Integrimi i qasjeve të fokusuara në komunitet
Zbatimi i policimit të fokusuar në komunitet i mbështetur në më shumë drejtori.		

Oficerët e trajnuar në mënyrë të përshtatshme

Nevoja për të trajnuar oficerët e komunitetit të sapoemëruar ose shtesë do të jetë një domosdoshmëri e vazhdueshme, megjithëse duket se PSS-ja është pothuaj në gjendje ta kryejë këtë në mungesë të mbështetjes së mëtejshme programore. Pas mbi dhjetë vjet programimi të FPKS-së, parashikohet që të ketë një masë të mjaftueshme oficerësh të trajnuar në komunitet për të kryer trajnime dhe mentorim për oficerët e sapoemëruar, dhe se konceptet janë integruar në trajnimin bazë të të gjithë policëve të rinj që hyjnë në shërbim. Kjo nuk ka pasur përparimin e shpresuar, për shkak të një numri çështjesh në nivelin e Akademisë së Policisë. Në këtë moment Akademia ka mbështetjen e disa donatorëve të tjerë dhe nuk duhet të jetë në qendër të mbështetjes nga Programi, megjithatë, Programi e ka të nevojshme të monitorojë masën në të cilën Akademia integron me sukses konceptet e policimit në komunitet në kurrikulën e saj të trajnimit.

Ndryshimet e propozuara në strukturën e policimit në komunitet, ku oficerët e komunitetit vendor kanë një përgjegjësi të shtuar për hetimet penale të nivelit parësor dhe në disa raste detyra të tjera të zbatimit, ka të ngjarë të ekspozojnë një boshllëk aftësish dhe nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Ky do të jetë veçanërisht rasti për ata oficerë të komunitetit që kanë qenë në detyrë për shumë vjet dhe nuk kanë ushtruar përgjegjësi më të gjera policore. Një nga disavantazhet e përcaktimit të përgjegjësisë të policisë së komunitetit nga kërkesat më të gjera të policisë është se aftësitë ekzistuese mund të humbasin ose aftësitë e reja të mos mësohen.

Kur të zbatohen, ndryshimet e propozuara do të zgjerojnë përgjegjësitë policore të oficerëve të komunitetit pa i dobësuar ato. Duhet pasur kujdes që të mos pakësohen aktivitetet aktuale të edukimit dhe parandalimit të kryera në shkollë dhe gjetkë. Në përgjithësi, avantazhet e fituara në pasjen e një elementi më fleksibël, më reagues dhe të integruar të policimit në komunitet shpresojmë të tejkalojnë çdo disavantazh të perceptuar. Megjithatë, ndryshimet e propozuara rishtazi do të funksionojnë në mënyrë të kënaqshme vetëm nëse të përfshirët marrin trajnimin e duhur për rolin e tyre të rishikuar në polici. Një trajnim i tillë duhet të jetë në fokus të Programit të Fazës së Tretë dhe të plotësohet nga iniciativë për rritjen e aftësive të kryera nga PSS-ja.

Fushat e mundshme të trajnimit, të cilat mund të mos identifikohen plotësisht derisa të miratohet dhe zbatohet Programi i ndryshimit të PSS-së, mund të përfshijnë:

- I. Sigurimi i vendeve të krimit dhe mbledhja e provave;
- II. Marrja e deklaratave;
- III. Aftësitë bazë të intervistës;
- IV. Aftësitë për zgjidhjen e konflikteve; dhe
- V. Plotësimi i dosjeve të çështjeve.

Përgjegjshmëria e Zbatimit të Policimit në Komunitet

Linja e dytë e mbështetjes për policimin në komunitet është përmirësimi i përgjegjshmërisë së policisë në ofrimin e një shërbimi të fokusuar në komunitet. Janë dy aktivitetet kryesore që do të zhvillohen në këtë linjë mbështetjeje: Së pari, ruajtja e sistemit të shoqërimit dhe monitorimit nga ekspertët e Programit të policimit që ishte një sukses i madh i fazës së dytë dhe, së dyti, vlerësimi organizativ dhe një sistem i mundshëm pilot i Kamerave të Vendosura në Trup (KVT) për të mundësuar një rishikim më të hollësishëm të veprimeve të policisë kur janë në kontakt me komunitetin.

Mbështetja për monitorimin e Programit

Për sa i përket monitorimit, përpjekja kryesore në Fazën e Tretë do të jetë vazhdimi i vizitave të rregullta nga eksperti ndërkombëtar i policimit dhe stafi tjetër i Programit që ka qenë një model kaq efektiv i mbështetjes në Fazën e Dytë. Vizitat të fokusohen në ndjekjen e trajnimeve, angazhimin dhe zgjidhjen e problemeve me drejtuesit e lartë në nivel drejtorie apo komisariati,

për mënyrën se si po vijon zbatimi, si dhe angazhimin në ecurinë e elementeve të ndryshme të mbështetjes së programeve. Kjo përfshin vazhdimin e punës sipas shtyllave të tjera, siç është mbështetja për përmirësimin e qëndrueshmërisë së funksionimit të Sektorëve për Analizë dhe Monitorim (SAM) dhe funksionimin e KLSP-ve përkatëse. Rregullsia dhe diapazoni i qëllimit të këtyre vizitave funksionon për të zhvilluar marrëdhëniet ndërmjet stafit të Programit dhe strukturave të policisë dhe mbështet vëmendjen e vazhdueshme për ecurinë e reformave.

Një sasi e konsiderueshme e kohës së Programit investohet në mekanizma të tillë monitorues, megjithatë ato përfaqësojnë një mekanizëm kritik me të cilin faza e tretë mund të sigurojë që ajo të mbetet e vetëdijshme për progresin në zbatimin e qasjeve të policimit në komunitet, ndikimin e ristrukturimit në policimin në komunitet, dhe identifikojnë çështjet e komunitetit dhe krimin në nivel drejtorie/komisariati që mund të kërkojnë asistencë programore.

Vlerësimi i kamerave të vendosura në trup

Është e qartë se MPB-ja dhe PSS-ja shohin avantazhe nëse oficerët pajisen me një teknologjinë KVT, për arsye të rritjes së përgjegjshmërisë së policisë, intensifikimit të mbledhjes së provave dhe mbrojtjes së punonjësve nga ankesat e pajustificuara ose shqetësuese. Përvoja ndërkombëtare ka treguar se kuadri i politikave që mbështet prezantimin dhe përdorimin operacional të KVT-ve është kompleks dhe i ndërlikuar, me masa mbrojtëse ligjore thelbësore të cilat duhen trajtuar. Për më tepër, ekziston çështja se ku ose si të kryhet studimi pilot, p.sh. sipas vendndodhjes gjeografike, përcaktimit të njësisë ose zonës së ndjeshmërisë së policisë ose shqetësimit publik.

Nëse MPB-ja dhe PSS-ja vendosin të kryejnë një sistem pilot me kamera trupi, Programi mund të mbështesë në mënyrë të dobishme hartimin dhe zbatimin e një kuadri/udhëzuesish të politikave dhe operacionale përkatëse. Theksohet se kjo është një fushë veprimi politike komplekse dhe shpesh e kontestuar, dhe këshillat ligjore dhe gjykimet do të jenë një faktor kritik për t'u marrë parasysh.

Në përputhje me udhëzimet e prokurimit të FPKS-së, Programi mund të dëshirojë, gjithashtu, të financojë blerjen e një numri të kufizuar kamerash dhe pajisjeve të lidhura, p.sh. njësitë e kompresimit dhe t'ruajtjes së videos, sistemet e monitorimit, sistemues dhe të karikimit etj., si përdorim në provë. Megjithatë, një mbështetje e tillë e kufizuar logjistike duhet të konsiderohet vetëm në konsultim dhe brenda fushës së përgjegjësisë së Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Duhet theksuar se mbështetja nga Programi me mjete logjistike dhe pajisje do të kufizohet në çdo studim pilot të drejtuar nga MB/PSSH-ja dhe të kryhet me rezervën e miratimit nga AKSHI, sipas rastit. Zbatimi i plotë i sistemit, nëse pilotimi do të jetë i suksesshëm në zhvillimin e një qasjeje koherente dhe efektive, do të jetë përgjegjësi e Qeverisë Shqiptare.

Mbështetja e Nivelit Drejtues të Policisë për të Integruar Qasjet e Policimit në Komunitet

Përveç rritjes ose ofrimit të aftësive të reja për oficerët e policimit në komunitet, ekziston nevoja për të përforcuar më tej konceptet dhe avantazhet e grumbulluara të filozofisë dhe të praktikës së policimit në komunitet me disa oficerë të lartë të PSS-së. Ndërsa pranohet se parimet e policimit në komunitet janë miratuar lehtësisht nga shumë oficerë individualë, veçanërisht në zonat pilot të Fazës Një dhe Dy, ekzistojnë prova që sugjerojnë se jo të gjithë oficerët e lartë i kanë integruar plotësisht qasjet në menaxhimin e zonës së tyre të policimit. Vetëm trajnimi nuk do ta korrigjojë këtë situatë dhe një aspekt kyç i fazës së tretë të programit do të jetë adresimi i qëndrueshmërisë së zbatimit përmes formave të shumta të mbështetjes. Kjo mund të përfshijë inkurajimin nëpërmjet vizitave monitoruese dhe mentoruese, së bashku me organizimin e seminareve/*workshop*-eve në Shqipëri, me pjesëmarrës nga brenda dhe jashtë shërbimit policor, ashtu dhe me kontribute ndërkombëtare për të diskutuar më tej avantazhet e policimit në komunitet.

Analiza dhe përgjegjshmëria e policimit në komunitet

Faza e tretë e Programit do të angazhohet veçanërisht në mbështetje të integritetit të policisë në sistemin në zhvillim të këshillave bashkiakë të sigurisë, si një qasje për koordinimin e

shërbimeve shtetërore që është testuar me sukses nga MPB-ja shqiptare gjatë Fazës së Dytë. Përpjekja tjetër madhore është nevoja për të mbështetur përmirësimet në përdorimin e të dhënave nga PSS-ja, duke përfshirë konkretisht SAM-et, të cilët janë të pranishëm në të gjitha Drejtoritë e PSS-së, por që jashtë vendndodhjeve pilot nuk kanë përfituar të gjithë mbështetje të mjaftueshme nga Programi.

Policia është e integruar mirë në këshillat për sigurinë e komuniteteve bashkiake		
KLSP-të funksionojnë në mënyrë efektive për të mbështetur sigurinë e komunitetit		PSS-ja i përdor në mënyrë efektive të dhënat për të menaxhuar prioritetet e policimit në komunitet
Mbështet funksionimin e KLSP-ve	Pilotimi i një sistemi më të mirë për menaxhimin e të dhënave të komunitetit	Përmirësime në mbështetjen e SAM-eve
OSC-të marrin pjesë dhe ndikojnë mbi PSS-në dhe KLSP-të		

Këshillat lokale të sigurisë publike

Fuqizimi i partneriteteve dhe i besimit reciprok ndërmjet policisë dhe aktorëve lokalë është rezultati kryesor i këtij Programi. Për të fuqizuar qasjet e partneritetit, në vitin 2016 u ngritën Këshillat Lokale të Sigurisë Publike (KLSP). Kjo ishte një nismë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e mbështetur nga Programi dhe më pas e pilotuar dhe e shtrirë në shumicën e bashkive gjatë nëntë muajve në vijim. Deri më sot, 56 nga 61 bashkitë thuhet se kanë krijuar komitete të sigurisë publike (vizitat në terren sugjerojnë se ky është një vlerësim tepër optimist, p.sh. në qarkun e Elbasanit u tha se vetëm një nga shtatë KLSP-të funksiononte mjaftueshëm shpesh për të qenë efektiv). Numri i KLSP-ve të krijuara dhe plotësisht efektive është ndoshta shumë i vogël dhe një rishikim për të vërtetuar ekzistencën dhe qëndrueshmërinë aktuale të këtyre strukturave është i vonuar.

Duhet të theksohet se KLSP-të janë themeluar me rekomandim të MB-së, por në mungesë të kuadrit rregullator ligjor. Kjo është një çështje që duhet të trajtohet nga MB-ja në të ardhmen, mundësisht me mbështetjen e Programit, nëse kjo asistencë konsiderohet e përshtatshme.

Për të ruajtur përfitimet e arritura tashmë dhe për të trajtuar ndryshimin aktual në kapacitetin e KLSP-së konkrete, do të jetë thelbësore të sigurohet mbështetje shtesë e vazhdueshme gjatë Fazës së Tretë. Kjo mbështetje duhet të fokusohet në komunitetet më të mëdha bashkiake, ku këshillat mund të përbëhen me përfaqësim adekuat. Kjo mbështetje shtesë duhet të përfshijë trajnime të mëtejshme, vizita mentorimi dhe monitorimi ose qasje të tjera për ngritjen e kapaciteteve, të cilat duhet të ofrohen në mënyrë të koordinuar me agjenci të tjera ndërkombëtare, si p.sh., Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), të cilat deri më sot kanë mbështetur KLSP-në në Shkodër dhe tetë zona të tjera bashkiake.

Duhet të ritheksohet se nuk parashikohet që nga Programi të ofrohet mbështetje për të gjitha KLSP-të, por duhet të hartohet një kriter ndërmjet të gjitha palëve të interesuara (MB, PSS, kryetarët e bashkive etj.) për të përcaktuar se në cilat vendndodhje do të jetë prioritar kjo mbështetje, për sa kohë dhe në çfarë mënyre – nuk sugjerohet që të përdoret një metodologji e vetme e ofrimit. Çdo rast duhet të trajtohet në bazë të veçantive të tij, duke pasur parasysh karakteristikat lokale politike, kulturore dhe komunitare, si dhe kapacitetin e këtyre grupeve për të përvetësuar dhe për të mbështetur mënyra të reja të punës. Përfshirja aktive e kryetarit përkatës të Bashkisë është e një rëndësie thelbësore, duke pasur parasysh përgjegjësinë e tyre ligjore për drejtimin e strukturave të KLSP-ve.

Programi mund të punojë me Organizatat e Shoqërisë Civile (OSC) nëpërmjet skemës së grandeve të Programit (shih seksionin specifik) për të ofruar udhëzime dhe mbështetje të përshtatshme për strukturat individuale të KLSP-ve, si metoda më efektive për të siguruar një lidhje të fortë midis këtyre këshillave dhe komuniteteve të tyre përkatëse, duke qenë, gjithashtu, një qasje e përfuturit të vlerës së shpenzimeve.

Qëllimi i përcaktuar i KLSP-ve, për të forcuar sigurinë publike si organ këshillues në bashki, dhe përbërja e tij e gjerë dhe përfaqësuese potencialisht e shndërrojnë këtë në një metodë të

rëndësishme dhe të besueshme të lidhjes së gamës së plotë të shërbimeve qeveritare me komunitetin. Aktualisht, kudo që KLSP-të konkrete janë aktivë, këto janë fokusuar në çështjet që lidhen me sigurinë publike; ato janë, gjithashtu, të autorizuar për të përmirësuar besimin ndërmjet njësive administratës publike (përfshirë PSS-në) dhe grupeve komunitare dhe qytetarëve individualë.

Duhet të theksohet se koncepti i KLSP-ve duhet të fokusohet në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe sigurisë së komunitetit lokal, shumë prej të cilave mund të jenë të një natyre të vogël që kërkojnë vetëm kryerjen e veprimeve korrigjuese me kosto të ulët. Plane më ambicioze dhe më të shtrenjta mund të jenë të përshtatshme në disa vendndodhje më të mëdha urbane të KLSP-ve, por roli kryesor i këtyre komuniteteve është të drejtojnë caktimin e burimeve të tyre në prioritetet kyçe të komunitetit, dhe jo të identifikojnë kërkesat e reja për burime.

Fazat e mëparshme të Programit FPKS nuk janë fokusuar veçanërisht në përmirësimin e llogaridhënies së policisë, megjithëse hartimi dhe dokumentacioni i Programit sugjeron se mund të krijohen raporte midis rritjes së reagimit të policisë, efektivitetit dhe perceptimeve të përmirësuar të publikut. Megjithatë, bazuar në studimin e programeve të zhvillimit të sigurisë publike/policore gjetkë në botë, është e qartë se grupet konsultative lokale, si KLSP-ja në Shqipëri, mund të përdoren për të përmirësuar performancën dhe sjelljen e policisë lokale. KLSP-të mund të identifikojë aktivitetet që kërkojnë vëmendjen e policisë dhe të sigurojë një vlerësim të efektivitetit dhe afateve të (ose mos)reagimit të policisë sipas pritshmërive të bashkisë. Një informacion i tillë jo vetëm që do të ndihmonte drejtuesit e policisë lokale në vlerësimin e performancës, por gjithashtu do të lejonte përmirësime afatgjata ose ndryshime në praktikat e policisë duke ofruar një lidhje të drejtpërdrejtë me reagimet e komunitetit dhe bashkisë. Programi do të luajë një rol në mbështetjen e çdo aktiviteti që forcon përgjegjshmërinë e policisë lokale.

Kjo nuk do të thotë që KLSP-të duhet të kërkojnë llogari policisë, duke iu shmangur përgjegjësi të veta. Që KLSP-të të funksionojë në mënyrë efektive, të gjithë partnerët përfaqësues duhet të punojnë në mënyrë të koordinuar dhe konsultative, duke pranuar se të gjitha institucionet/organizatat e tyre kanë një rol për të luajtur në përmirësimin e cilësisë së sigurisë së komunitetit lokal.

Është sugjeruar që strukturat e KLSP-ve do të përfitonin nga mekanizmat shtesë koordinues në nivel shtetëror. Ekzistojnë qartazi avantazhe për një bashkërendim më të mirë nëpërmjet identifikimit lokal të prioritetëve dhe qasjeve për zgjidhjen e problemeve të miratuara në nivel bashkiak, mund të vuajë nëse një zgjerim i koordinimit do të çonte në një drejtim të një niveli më të lartë. Programi do të duhet të angazhohet me MPB-në nëse çështja e koordinimit të nivelit më të lartë të KLSP-ve do të kërkojë një shqyrtim të politikave.

Fuqizimi i Sektorëve të Analizës dhe Monitorimit

Krijimi i SAM-eve ka treguar një ndikim të vërtetë në vendndodhjet pilot dhe ka çuar në krijimin e ekipeve nga PSS-ja në të gjitha Rrethet Lokale të Policisë (RLP). Miratimi i kësaj strukture ka potencialin për t'i mundësuar PSS-së të zbatojë format e policimit të udhëhequra nga komuniteti dhe të dhënat në mënyrë më strategjike, por është e qartë se suksesi i zbatimit ndryshon në vende të ndryshme, për shkak të kufizimeve në të kuptuarit e qasjes, dallimeve në personel, përshtatshmërisë për rolet e analizës dhe kufijtë e mbështetjes së mundshme të Programit në fazën e dytë. Sektorët janë, gjithashtu, të lidhur dobët për shkak të një aftësie të kufizuar qendrore për të pranuar dhe për të integruar të dhëna të tilla për t'u përdorur nga Selia Qendrore, dhe për shkak të mungesës së priorizimit të qasjeve të bazuara në të dhëna.

Faza e Tretë do të fokusohet në zgjerimin e mbështetjes gradualisht nga vendndodhjet e projekteve pilot në të gjitha DLP-të për t'i ndihmuar ato në zbatimin efektiv të konceptit dhe për të siguruar që informacioni të menaxhohet dhe të përdoret në mënyrë adekuate në të gjithë nivelin e organizatës. Në shumë vende kjo mund të përfshijë punën me drejtuesit e policisë së DLP-së për t'i sensibilizuar ata për dobinë dhe avantazhet e aftësisë që ata tashmë kanë. Kjo gjithashtu do të përfshijë punën me personelin e sektorit për t'i udhëzuar dhe mbështetur ata që të bëhen analistë efektivë. Së fundmi, ai do të përfshijë punën me Drejtorinë Qendrore për të

përmirësuar menaxhimin qendror dhe përdorimin e këtij informacioni, dhe për të inkurajuar një kulturë të pritshmërive rreth cilësisë dhe përdorimit të të dhënave.

Faza e tretë do të duhet të ketë prioritet mentorimin e menaxhmentit të lartë dhe të mesëm për të siguruar që roli specifik i sektorëve në planifikim të kuptohet më mirë. Ishte e qartë se nuk ka një kuptim të qartë se si sektorët ndryshojnë nga seksionet në saje të përdorimit të analizës së kriminalitetit. Duke qenë se strukturat aktuale në Selinë Qendrore nuk i pasqyrojnë ato të sektorëve të RPL-së, duhet t'i kushtohet vëmendje krijimit të një njësie qendrore për integrimin dhe menaxhimin e sektorëve dhe përmirësimin e të kuptuarit, përdorimit dhe caktimit të detyrave të sektorëve të RPL-së.

Një pjesë kyçe e përmirësimit të përdorimit dhe rrjedhës së të dhënave brenda organizatës mund të jetë një pilot i sistemit të futjes së informacionit të bazuar në tablet në ekipet e policisë së komunitetit, i ngjashëm me atë që po përdoret me sukses nga policia rrugore. Një sistem i tillë do të adresonte disa nga problemet themelore funksionale që pengojnë transferimin e informacionit nga oficerët që e mbledhin atë në një format të dobishëm për të gjithë, që mund të mundësojë vendimmarrje dhe shpërndarje më të mirë të burimeve. Ka dallime domethënëse midis policimit në komunitet dhe qarkullimit rrugor, që do të thotë se nuk është detyrë e lehtë përshtatja dhe zbatimi i një sistemi që mund të kapë në mënyrë të dobishme gamën më të gjerë të formave më komplekse të informacionit që do të duhet të regjistrohen. Është përtej qëllimit të këtij Programi zbatimi i plotë i një sistemi tabledash të policimit në komunitet, por nëse një projekt pilot në një vend të caktuar tregon një ndikim të dukshëm në cilësinë dhe rrjedhën e informacionit, atëherë QSH-ja do të ketë një bazë provash nga e cila mund të gjykojë, në lidhje me investimin e tyre në këtë kapacitet. Ashtu si KVT-të, ky lloj projekti i IT-së duhet të përparojë vetëm me miratimin e AKSHI-t, për të siguruar që ai të jetë i bazuar në planin e përgjithshëm të menaxhimit të IT-së nga Qeveria Shqiptare.

Anketat në komunitet

Mbështetja për aftësinë analitike të RLP-ve dhe KLSP-ve do të thotë që Faza e Tretë duhet të vazhdojë më tej me sondazhet në komunitet, të cilat i japin PSS-së dëshmi të qarta të performancës së tyre dhe dinamikës së besimit të komunitetit. Kryerja e vazhdueshme e Anketës vjetore të Perceptimit për Policinë do të sigurojë një masë të nivelit të lartë të suksesit në zhvillimin e besimit të komunitetit. Sistemi Lokal i Matjes së Sigurisë (SLMS) ofron të dhëna edhe më të mira për të orientuar policinë drejt prioritetëve të komunitetit në fusha specifike, por për shkak të kostos së anketës nuk mund të kryhet aq gjerësisht sa do të ishte ideale. Pavarësisht këtyre kufizimeve, nuk ka asnjë mënyrë më të lehtë apo më të mirë që Programi të mbështesë mbledhjen e këtyre të dhënave të cilësisë së lartë në nivel vendi/rajonar dhe të vazhdojë t'i mundësojë PSS-së të zhvillohet në një organizatë të orientuar nga të dhënat.

Fazat e mëparshme të Programit u përpoqën të krijonin një model të qëndrueshëm për anketat brenda organizatave partnere të komunitetit, por pa sukses. Vëzhgimet kombëtare ose rajonale të këtij lloji menaxhohen më shpesh nga agjencia kombëtare e statistikave, në rastin e Shqipërisë Instituti i Statistikave (INSTAT). Faza aktuale e Programit duhet të synojë zhvillimin e marrëdhënieve me INSTAT-in për të mundësuar transferimin e menaxhimit të vëzhgimeve në modelin e tij standard të vëzhgimeve kombëtare.

Kapacitet i specializuar i policisë për prioritetet komunitare

Fokusi në zhvillimin dhe përmirësimin e zbatimit të një qasjeje të policimit në komunitet në PSS është përforcuar, duke siguruar që policia të ketë aftësitë e specializuara për të menaxhuar dhe për t'iu përgjigjur prioritetëve të komunitetit në momentin që ato identifikohen. Gjatë fazës së dytë, Programi u zgjerua nga fokusi i tij në dhunën në familje, me një element i fortë Programi që mbështet ndërgjegjësimin e të rinjve, për të adresuar një shqetësim të identifikuar të komunitetit në lidhje me policimin e qarkullimit rrugor. Këto tri fusha të gjinisë, qarkullimit rrugor dhe rinisë përfaqësojnë çështje kyçe të policisë që kanë nevojë për mbështetje nëse PSS-ja dëshiron të përmbushë pritshmëritë e komunitetit dhe të përmirësojë ofrimin e shërbimeve të saj.

Reagimi policor ndaj prioriteteve komunitare		
Reagimi policor ndaj dhunës në familje	Policimi efektiv i qarkullimit rrugor	Përmirësimi i ndërgjegjësimit të të rinjve
- Trajnim për reaguesit e parë - Zbatimi i monitorimit	- Ruajtja e kontrollit të shpejtësisë - Zbatimi i sistemeve automatike	- Ndërgjegjësimi në shkolla

Përmirësimi i reagimit fillestar për të mbijetuarit e dhunës në familje

Ndërsa reagimi i policisë ndaj të mbijetuarave është përmirësuar dukshëm, mbeten kufizime të dukshme në masën në të cilën kjo është një përgjigje e qëndrueshme. Çështja kryesore është se shumica e punonjësve në polici, të cilët janë të trajnuar mirë për reagimet e duhura, janë në kuadër të funksionit të policimit në komunitet dhe si të tillë nuk janë gjithmonë të parët që ndeshet me një viktimë që kërkon mbështetje. Trajnimi dhe angazhimi më i kufizuar me punonjësit e patrullës dhe atyre që bëjnë pritjen e parë në tavolinat e komisariateve mund të jenë shkak që reagimet fillestare ndaj ankesave të mos plotësojnë standardet e dëshirueshme dhe mund t'i dekurajojnë viktimat të angazhohen më tej me policinë. Riorganizimi i synuar i strukturës së policisë do t'i transferojë në poste të ndryshme oficerët e sensibilizuar rregullisht, dhe kjo mund të ndikojë në mundësinë që një viktimë të trajtohet siç duhet kur kontakton policinë.

Për t'iu përgjigjur kësaj çështjeje të identifikuar, Faza e Tretë e Programit duhet të kryejë trajnime të mëtejshme sensibilizuese për kërkesat ligjore dhe aftësitë praktike për gamën e oficerëve që vijnë në kontakt me viktimat. Realizimi i këtyre aftësive mund të përforcohet nëpërmjet një angazhimi më të gjerë monitorues, në nivelin e zonës ku struktura e re e policisë do të vendosë punonjësit që kanë kontaktin më të madh me komunitetin dhe që duhet të marrin ankesat më të drejtpërdrejta. Pjesa më e madhe e angazhimit monitorues mund të përafrohet dhe kryhet si pjesë e përpjekjeve për të siguruar që ristrukturimi të arrijë përmirësimet e synuara në zbatimin e policimit në komunitet.

Si trajnimi, ashtu edhe monitorimi duhet të kryhen në bashkëpunim me agjencitë e tjera përkatëse qeveritare, veçanërisht me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), nën të cilën janë punonjësit socialë të dhunës në familje dhe duhet të synojnë të përforcojnë zbatimin e mekanizmit kombëtar të referimit, që përfaqëson koordinimin reagues të përgjithshëm shtetëror.

Mbështetja për Drejtorinë e Qarkullimit Rrugor

Ekipi i hartimit të Projektit vuri në dukje përdorimin e gjerë dhe të dobishëm të të dhënave nga drejtori dhe drejtuesit e lartë të Drejtorisë së Qarkullimit Rrugor. Përdorimi i të dhënave të qarkullimit rrugor dhe i lëvizjes së automjeteve përdorej qartë për të orientuar angazhimin e patrullave të qarkullimit rrugor dhe teknologjinë e matjes së shpejtësisë. Shqetësimet kryesore në këtë fushë tani janë shkalla në të cilën PSS-ja është e aftë dhe e përgatitur për të ruajtur aftësinë aktuale.

Aksidentet fatale në qarkullimin rrugor janë reduktuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Shifra e regjistruar për vdekjet nga automjetet është 160 gjatë 12 muajve të fundit. Faza e mëparshme e Programit ishte e suksesshme në mbështetjen e zbatimit të një numri kamerash për kontrollin e shpejtësisë, që ka të ngjarë të kenë kontribuar në këtë përmirësim, së bashku me një sistem përpunimi automatik për gjomat. Ndërkohë që sistemi i plotë automatik nuk është zbatuar ende, për shkak të vonësve në miratimet në lidhje me menaxhimin e informacionit të IT-së, kamerat automatike tashmë kanë kontribuar në reduktimin e mundësive për sjellje të papërshtatshme të policisë me përmirësime të parashikuara konsekuente në perceptimet e reputacionit të policisë (këto ndërhyrje janë relativisht të reja dhe ndoshta ende shumë shpejt për të ndikuar në rezultatet e përgjithshme të studimit të perceptimit të policisë).

Përfitimet e arritura në efektivitetin e strategjive të zbatimit të policisë rrugore duhet të konsolidohen dhe të forcohen. Ndonëse mund të mos jetë e përshtatshme të investohet në një pjesë të madhe të pajisjeve të reja ose mbështetjes teknologjike, ndihma e Programit duhet të ofrohet për të ruajtur nivelet ekzistuese të burimeve të IT-së dhe për të siguruar që sistemi i

automatizuar i kontrollit të shpejtësisë të bëhet plotësisht funksional. Procesi i projektimit vuri në dukje se Drejtorisë së Qarkullimit Rrugor vazhdon t'i mungojë një buxhet i përshtatshëm i dedikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve aktuale dhe trajtimin e çështjeve të pajisjeve, duke përfshirë kërkesat ligjore për ekzaminim të rregullt teknik të pavarur. Mbështetja e Programit për Drejtorinë e Qarkullimit Rrugor duhet të ketë prioritet vlerësimin e saktë të kostove të vazhdueshme të përfshira në ruajtjen e kapaciteteve aktuale, dhe më pas të përpiqet të mbështesë Drejtorinë për të siguruar financim të përshtatshëm përmes PSS-së dhe MB-së.

Rritja e ndërgjegjësimit në shkolla

Rritja e ndërgjegjësimit me të rinjtë për çështjet kyçe të interesit të komunitetit ka qenë një forcë e qëndrueshme e Programit dhe duhet të ruhet dhe forcohet në Fazën e Tretë. Çështjet e rritjes së ndërgjegjësimit janë zhvilluar në lidhje me të rinjtë dhe shkollat, me policinë në komunitet, që ofron aktivitete të synuara dhe të fokusuara në dhunën me bazë gjinore, sigurinë në qarkullimin rrugor, dëmtimin nga droga dhe tema të tjera. Sipas planit aktual të ristrukturimit, oficerët e komunitetit, të cilët janë të fokusuar në aktivitetet e ndërgjegjësimit në shkolla, do të përqendrohen në njësi të vogla specifike, në vend që të shpërndahen nëpër ekipe më të mëdha të policimit në komunitet. Ky ndryshim mund të ndikojë në aftësitë aktuale të caktuara për rritjen e ndërgjegjësimit dhe Programi duhet të punojë për të siguruar që kjo të rezultojë në përmirësime në masën në të cilën policia angazhohet me të rinjtë për çështjet e sigurisë.

Aktivitetet e ndërgjegjësimit të shkollave të drejtuara nga PSS-ja shpesh përafrohen ose zhvillohen në koordinim me Oficerët e Sigurisë së Shkollave (OSS) të punësuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve (MAS), të cilët janë, gjithashtu, përgjegjës për ofrimin e një sërë masash trajnimi/mbështetjeje për sigurinë dhe sigurinë e fëmijëve dhe komunitetit. Koncepti i OSS-ve u prezantua nga MAS-i në vitin 2018 dhe OSS-të janë tashmë të pranishëm në shumicën e shkollave të mëdha në të gjithë Shqipërinë. 70 OSS-o të tjera janë rekrutuar gjatë 12 muajve të fundit, duke arritur tashmë një total faktik prej 220. Ka plane për të rekrutuar më shumë. Trajnimi fillestar i OSS-ve, që zgjati katër javë, u zhvillua në Akademinë e Sigurisë. Mbajtja dhe përmirësimi i trajnimit të punonjësve të PSS-së dhe OSS-ve të MAS-së për ndërgjegjësimin në shkolla do të jetë një aktivitet kyç për të mbështetur Programin e Fazës së Tretë, së bashku me ofrimin e asistencës teknike për Ministrinë në lidhje me hartimin dhe krijimin e protokolleve të trajnimit.

Nevoja për bashkëpunim dhe për koordinim të ngushtë dhe të vazhdueshëm ndërmjet nismave të trajnimit të MAS-së dhe PSS-së për ndërgjegjësimin në shkolla do të jetë një çështje e rëndësishme për t'u menaxhuar bashkërisht. Mundësitë për trajnime të përbashkëta PSS/OSS duhet të identifikohen dhe ofrohen, aty ku është e përshtatshme dhe e mundur. Mund të jetë e dobishme që të ketë një rishikim të hershëm të përbashkët (MB, PSS, MAS) të programeve aktuale të ndërgjegjësimit në shkolla, rezultati i të cilit mund të drejtojë më mirë aktivitetet në të ardhmen.

Skema e grandeve

Komponenti i Programit për grandet është një element i rëndësishëm i suksesit të Programit dhe do të ruhet në Fazën e Tretë në të njëjtin nivel angazhimi. Kjo përfshin përdorimin parësor të grandeve të mesme (10,000 euro), të cilat kanë mundësuar projekte më me ndikim dhe më pak shpenzime për menaxhimin e FPKS-së. Skema e Grandeve do të përdoren për të përforcuar reformat dhe për të përmirësuar angazhimin e komunitetit, duke lidhur dhe financuar OSC-të përkatëse për të ndikuar në reformat që po zbatohen brenda vendit. Fushat e mundshme të ndërhyrjes përmes skemës së grandeve duhet të shqyrtohen dhe vendosen nga Komiteti Drejtues i Projektit (KDP).

Prioritetet fillestare të Skemës së Grandeve do të jenë përfundimi i KLSP-ve, duke mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të informuar të komunitetit; dhe për të siguruar që policimi në komunitet të jetë i angazhuar mirë me grupet e motivuara të komunitetit që përfaqësojnë gamën e aktorëve kryesorë (së paku femra, të rinj), për fuqizimin e përfaqësimit dhe raportit ndërmjet bashkisë dhe nivelit të zonës. Duke financuar forma të vogla të mbështetjes së drejtpërdrejtë për përpjekjet e

OSC-ve për shqetësimet e komunitetit, OSC-të do të jenë në gjendje të marrin pjesë në takimet e KLSP-ve me një sens të informuar për çështjet aktuale të komunitetit.

Ndërsa përdorimi i grandeve në Fazën e Dytë u konsiderua mirë, disa qasje mund të përshtateshin për të maksimizuar vlerën e shtuar të sistemit. Së pari, grandet duhet të përdoren për të përforcuar drejtpërdrejt ofrimin e shërbimeve. Kjo do të thotë që grandet duhet të përdoren për të mbështetur format e angazhimit të drejtpërdrejtë të komunitetit dhe të ofrimit të shërbimeve, duke përfshirë aktivitete të tilla, si angazhimi dhe mbështetja e të mbijetuarve, dhe aktivizimi i OSC-ve dhe angazhimi në KLSP. Përqendrimi ë ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta do të zvogëlojë rrezikun që grandet të përfundojnë vetëm në mbledhjen e të dhënave, ndërsa ato mund t'i ofrojnë komunitetit akses më të shtuar në shërbime. Roli i grandeve nuk duhet të jetë zëvendësimi i shërbimeve qeveritare, por ai duhet të jetë siguri i një angazhimi më të mirë të komunitetit në ato shërbime.

Së dyti, Programi duhet të inkurajojë një koordinim më të madh ndërmjet fituesve të grandeve. Duke pasur parasysh rolin e grandeve për të siguruar që komunitetet të jenë të angazhuara mirë në zbatimin e përgjithshëm të policimit në komunitet, është e rëndësishme që ata të punojnë së bashku dhe të vlerësojnë dinamikën e përgjithshme, në lidhje me përpjekjet e Programit. Skema e grandeve duhet të inkurajojë dhe të mbështesë propozimet e përbashkëta (ku secili nga përfituesit mund të pretendojë deri në 10,000 euro), ose të konsiderojë zhvillimin e proceseve të mësimi të përbashkët për grandet me objekte qendrore të mbivendosura. Komuniteti i OSC-ve në Shqipëri i përqendruar në policim është relativisht i vogël, kështu që një koordinim i tillë nuk do të jetë kompleks, megjithatë grupet e ndryshme kanë çështje të ndryshme qendrore dhe Programi duhet të punojë për të siguruar që mundësitë për koordinim të shfrytëzohen në mënyrë aktive.

Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë

Nevoja për një koordinim dhe bashkëpunim më të mirë ndërmjet agjencive ndërkombëtare dhe donatorëve të përfshirë në programet e zhvillimit të sigurisë dhe drejtësisë në Shqipëri është e qartë, por mjetet për të zgjidhur këto çështje janë kryesisht përtej objektivit të këtij raporti. Përgjegjësia për zbatimin e një qasjeje të përmirësuar dhe të koordinuar duhet të merret nga vetë institucionet ndërkombëtare në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë Shqiptare.

MB-ja ka shprehur dëshirën e qartë që të mbetet plotësisht e përfshirë në drejtimin dhe zhvillimin e programeve të ardhshme të policisë dhe asistencës për sigurinë. Përfshirja e vazhdueshme e MB-së në FPKS-ë është e rëndësishme, ndërsa të gjitha ndërhyrjet dhe veprimet janë në mbështetje të synimeve dhe detyrave specifike të këtij Programi për të forcuar policimin në komunitet. Duhet mbajtur mend se MB-ja e vendos vetë kuadrin e politikave të veta dhe strukturave për të cilat është përgjegjëse, përfshirë PSS-në. Politikat mund të lidhen me objektiva më të gjerë të qeverisë ose të jenë të përbashkëta me ministri të tjera, ku kërkohen përpjekje shumëministrorë, p.sh., çështjet e sigurisë kufitare apo migracionit. Marrëdhëniet ndërmjet MB-së dhe strukturave në varësi të saj janë në thelb të natyrës hierarkike, ku politika është përgjegjësi e MB-së, ndërsa përmbushja strategjike përkundrejt kërkesave të politikave është përgjegjësi e strukturave të veçanta, siç është kryerja e aktiviteteve në mbështetje të strategjive. MB-ja ka, gjithashtu, përgjegjësinë kryesore për të kërkuar llogari nga strukturat e saj për përmbushjen dhe sjelljen kolektive dhe individuale. Për të gjitha këto dhe shumë arsye të tjera, do të jetë thelbësore që MB-ja të luajë një rol në Programin e ri dhe çdo mbështetje ndërkombëtare pasuese për policimin.

Mbështetja e zhvillimit për sektorët e sigurisë dhe drejtësisë ofrohet aktualisht nga Qeveria Suedeze, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Bashkimi Evropian për Zbatimin e Ligjit në Shqipëri (EU4LEA), OSBE-ja, Mbretëria e Bashkuar (MB) dhe një sërë donatorësh të tjerë dypalësh. Mbështetja teknike (në krahasim me atë të ofruar përmes një optike zhvillimi) ofrohet nga shumë vende të tjera në marrëdhënie dypalëshe. Disa nga këta partnerë punojnë në mënyrë specifike në fushat ku mbivendosen dhe plotësojnë aspektet kyçe të Fazës së Tretë të propozuar, veçanërisht në aspektin e dhunës në familje dhe forcimit të sistemit KLSP-ve.

Ndërsa do të ketë nevojë që Ekipi i Menaxhimit të Projektit (EMP) të mbetet në bashkëpunim të ngushtë dhe si ndërlidhës me partnerët e tjerë zhvillimorë, për të shmangur mbivendosjen e përpjekjeve, theksohet përsëri që përgjegjësia kryesore për koordinimin e përgjithshëm të nivelit strategjik duhet t'u mbetet partnerëve ndërkombëtarë dhe vetë Qeverisë Shqiptare. Agjencia Shtetërore për Programet Strategjike dhe Koordinimin e Ndihmës (ASPSKN), me seli të Zyra e Kryeministrit, do të jetë në qendër të këtyre përpjekjeve.

Gjinia dhe të drejtat e njeriut

Programi ka qenë mjaft i qëndrueshëm në integrimin e konsideratave gjinore dhe të të drejtave të njeriut në aktivitetet dhe qasjet e Programit. Kjo qasje duhet të ruhet në Fazën e Tretë, për shkak të qëndrueshmërisë së vazhdueshme të çështjeve gjinore, si një temë shqetësuese për policimin në komunitet. Konsideratat gjinore dhe të të drejtave të njeriut përfshijnë:

- Barazia gjinore në të gjitha aktivitetet e Programit;
- Ngritja e kapaciteteve sipas shtyllës 3 të Programit për të përmirësuar reagimet e PSS-së për të ndihmuar në trajtimin e krimeve të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, përfshirë sulmet seksuale;
- Një fokus në grupet minoritare dhe çështjet gjinore, si pjesë e kriterëve të përzgjedhjes për grandet (e vogla);
- Përfaqësim i fortë i grupeve minoritare dhe grave në komitetet përzgjedhëse për SG-të;
- Treguesit e ndjeshëm ndaj gjinisë dhe minoriteteve brenda treguesve të rezultateve të programit.

Profili dhe shtrirja e Programit

Siç u përmend në rishikimin e jashtëm të Programit të Fazës së Dytë, nuk ekziston vetëm nevoja për të përmbushur objektivat e Programit të përgjithshëm, por është, gjithashtu, e nevojshme për t'u demonstruar të tjerëve, duke përfshirë një audiencë të madhe të jashtme, qasjet që përdoren dhe arritjet ose sfidat e përjetuara. Ekziston, gjithashtu, një kërkesë që vazhdimisht të garantohet që aktivitetet e Programit nuk orientohen nga oferta, por reflektojnë nevojat individuale dhe të komunitetit. Për të siguruar rëndësinë e vazhdueshme të rezultateve të Programit, diskutimi dhe konsultimi në një shtrirje më të gjerë të individëve dhe organizatave duhet të jetë pjesë e procesit të planifikimit vjetor të FPKS-së. Siç u përmend më sipër në një seksion të mëparshëm të raportit, ekziston gjithashtu nevoja për përmirësimin e koordinimit me institucionet e tjera ndërkombëtare, që punojnë në mbështetje të përmirësimit të sigurisë dhe të drejtësisë në Shqipëri.

Sugjerohet që mbajtja e një aktiviteti vjetor për të demonstruar progresin e Programit, për të debatuar dhe për të diskutuar çështjet e zhvillimit të sigurisë dhe drejtësisë, marrjen e komenteve nga përfituesit e Programit dhe identifikimin e prioriteteve të Programit të ardhshëm, duhet të jetë pjesë e çdo plani vjetor pune. Kjo ngjarje është njëkohësisht një mundësi për të shfaqur Programin dhe për të rritur përfshirjen dhe koordinimin e përpjekjeve ndërkombëtare për të trajtuar çështjet ndërsektoriale (të tilla si çështjet e menaxhimit të burimeve njerëzore që janë përtej qëllimit për t'u trajtuar brenda këtij Programi). Ata që do të ftohen në një aktivitet të tillë, përveç partnerëve kryesorë të Programit, do të përfshinin përfaqësues nga departamentet përkatëse të qeverisë, bashkitë lokale, shoqëria civile, akademja, biznesi, institucione të tjera të drejtësisë penale etj. Ndërsa aktiviteti do të organizohej dhe financohej nëpërmjet Programi, objekti i tij i gjerë do të kërkonte kontribut të konsiderueshëm nga MB-ja. Një aktiviteti i tillë vjetor mund të vazhdojë përtej kohëzgjatjes së Programit dhe të miratohet nga MB-ja si një ndodhi vjetore, ku mund të diskutohen dhe bihet dakord mbi çështjet e sigurisë së komunitetit.

Projektbuxheti

Qeveria Suedeze ka treguar se një buxhet prej 36 milionë korona do të vihet në dispozicion për financimin e aktiviteteve gjatë një periudhe pesëvjeçare të zbatimit. Projektimi parashikon që shtylla e policimit në komunitet do të jetë përpjekja kryesore, por çdo shtyllë do të jetë një investim i rëndësishëm dhe i nevojshëm për të arritur qëllimet e synuara. Rregulloret e SIDA-s ofrojnë fleksibilitet për të rregulluar fondet e alokuara gjatë zbatimit, në lidhje me vlerësimet e partnerit zbatues.

Menaxhimi i Programit dhe qeverisja

Në përputhje me fazat e mëparshme të Programit, Ambasada Suedeze e ka bërë të qartë se ata dëshirojnë t'ia kontraktojnë menaxhimin e projektit të Programit të fazës së tretë një kompanie tregtare. Ky model funksionoi me sukses gjatë fazave të mëparshme të FPKS-së. Si i tillë, EMP-ja duhet të përbëhet nga një personel prej 4+, duke përfshirë një menaxher të përgjithshëm Programi, një këshilltar policor ndërkombëtar, një ekspert M&E, një menaxher të skemës së grandeve dhe më tej personel të mëtejshëm mbështetës lokal sipas nevojës.

Një pjesë e rëndësishme e përgjegjësisë së EMP-së do të jetë sigurimi i mbështetjes me punë sekretarie për Komitetin e përgjithshëm Drejtues të Projektit. Përbërja e KDP-së gjatë fazave të mëparshme të FPKS-së u gjykua si e përshtatshme, me MPB-në dhe PSS-në të përfaqësuar në nivele të larta, së bashku me individë nga Ambasada Suedeze, MAS-ja, OSC-të dhe Shoqatën e Bashkive. Takimet e KDP-së zakonisht mbaheshin dy herë në vit. Për të përmirësuar bashkërendimin dhe komunikimin në nivelin e zbatimit të Programit, mund të jetë e përshtatshme që të ftohen përfaqësues të programeve të tjera të sigurisë dhe drejtësisë që të bëhen pjesë e KPD-së, ndoshta me status vëzhguesi.

Në përputhje me rekomandimet e vlerësimit të vitit 2020 të fazës së mëparshme, ky propozim projektimi nuk përcakton kuadrin specifik të monitorimit për të shmangur pengimin e një kompleti treguesish që nuk janë të bazuar në mënyrë të përshtatshme në planin të zbatimit të Programit aktual të zhvilluar nga EMP-ja. Parimet që duhet të zbatohet kuadri i monitorimit janë ato të një fokusi të përmirësuar të rezultateve të përshtatur me strukturën e Programit. Rezultatet për Fazën e Tretë janë kryesisht ato të konsolidimit të efekteve në të gjithë vendin dhe përmirësimeve në qëndrueshmërinë e reformave, që janë arritur deri më tani. Si i tillë, aneksi A paraqet një strukturë për kuadrin e monitorimit, së bashku me sugjerimet e llojeve dhe nivelit të duhur të treguesve, të cilat mund të zhvillohen më tej nga EMP-ja. Zhvillimi i një kuadri të plotë monitorimi të lidhur me aktivitetet e Programit është një detyrë kritike dhe duhet të përfundojë në 6 muajt e parë të zbatimit.

Ndërsa çështja e përgjithshme e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (PSS) është përtej qëllimit të këtij Programi, takimet e KPD-së mund të tërheqin vëmendjeje në lidhje me këtë çështje duke e mbajtur si një temë të qëndrueshme mbi qëndrueshmërinë e stafit të policisë në pozicionet kyçe të angazhuara me Programin. Monitorimi dhe matja e ndryshimeve të personelit në fushat kryesore partnere të Programit mund të shërbejë si një mënyrë për të ruajtur ndërgjegjësimin për çështjet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Potencialisht, kjo mund të marrë formën e trajtimit të pikave kyçe qendrore si “kampione” të policimit në komunitet dhe të inkurajimit të stabilitetit të tyre në pozicion, një qasje që është miratuar më parë me njëfarë suksesi. Kjo mund të jetë gjithashtu një çështje e zakonshme për diskutim në aktivitetin vjetor, për të përfshirë një gamë më të gjerë partnerësh të PSS-së në menaxhimin e çështjes.

Ashtu si në fazat e mëparshme të FPKS-së, grupet teknike të punës duhet të krijohen aty ku është e nevojshme, duke kërkuar përfaqësim nga të gjitha ministritë, institucionet dhe organizatat përkatëse.

KPD-së do t'i duhet të përmbushë kërkesat e Qeverisë Suedeze për asistencën zhvillimore (raportet dyvjeçare etj.), dhe të jetë përgjegjëse për drejtimin, menaxhimin dhe monitorimin e kornizës së përgjithshme të Programit.

Faza tranzitore dhe mbyllja e Programit

Planifikimi i kalimit drejt mbylljes së Programit, i njohur zakonisht si strategjia e daljes, është një pjesë e rëndësishme e projektimit të Programit, por bëhet veçanërisht kritike kur ndërhyrja ka mbështetur në mënyrë efektive disa përmirësime reale në qasjen dhe performancën organizative. Parashikohet që kjo fazë e FPKS-së të ketë një kohëzgjatje maksimale prej pesë vitesh, duke përfunduar diku në vitin 2028. Në atë kohë, të tria fazat e Programit të asistencës suedeze do të kenë ekzistuar për më shumë se 16 vjet dhe shpresojmë se do të kenë mbështetur një përmirësim të qëndrueshëm në policimin në komunitet dhe kur të vendoset që të mos këshillohet asnjë zgjatje e mëtejshme apo Program vijues.

Kalimi në procesin e mbylljes së Programit mund të përkufizohet si një qasje e planifikuar paraprakisht në të cilën organizata zbatuese, ose ekipi i tyre i menaxhimit të Projektit, ia dorëzon përgjegjësinë për drejtimin e Programit partnerëve ose përfituesve lokalë. Në rastin e FPKS-së, partnerët kryesorë vendorë janë MPB-ja dhe PSS-ja, megjithëse përfituesit përfshijnë një grup shumë më të madh, duke përfshirë individët dhe komunitetet, shqetësimet e të cilëve për sigurinë shprehen më të menjëhershme si rezultat i Programit. Në rastin e FPKS-së, për të filluar procesin e mbylljes së Programit, rekomandohet fuqimisht një Rishikim Afatmesëm (RAM) i jashtëm i pavarur afërsisht 2.5 vjet pas fillimit të zbatimit. RAM-i duhet të fokusohet në qëndrueshmërinë e asaj që është arritur deri në atë pikë dhe të përdoret për të drejtuar përshtatjet drejt objektivave dhe objektivit të Programit për të përmirësuar qëndrueshmërinë e rezultateve që janë arritur dhe të ri-orientojnë përpjekjet aty ku tashmë ka prova që rezultatet nuk mund të arrihen.

Në lidhje me atë që ndodh pas mbylljes së Programit, zbatimi i vazhdueshëm i një sistemi efektiv monitorimi dhe vlerësimi gjatë gjithë shtrirjes së Programit dhe më gjerë merr një rëndësi shtesë. Rishikimet e jashtme vjetore, aty ku ato kryhen, duhet të fokusohen në sistemet ekzistuese të monitorimit dhe vlerësimit dhe të shqyrtojnë me kujdes progresin e bërë, veçanërisht në nivelin e produktit.

Çështjet specifike që do të duhet të kuptohen nga MB-ja dhe PSS-ja, veçanërisht nëse nuk realizohet një Program pasues, do të përfshinin masat për mirëmbajtjen e pajisjeve të blera përmes Programit (çaktimi i buxheteve vjetore të mirëmbajtjes etj.) dhe planifikimi dhe financimi i kurseve shtesë që konsiderohen të nevojshme për programin normal arsimor të policisë.

Programet e asistencës për zhvillim janë nga natyra të përkohshme dhe ato përfundojnë. Kalimi në strategjitë e mbylljes mund të ndihmojë për të siguruar që objektivat e Programit të jenë përmbushur, se përfitimet e grumbulluara nuk do të humbasin dhe se është krijuar kapaciteti për të tjerët që të vazhdojnë punën pas përfundimit të financimit të jashtëm.

Risku

Risqet që lidhen me zbatimin e Programit nuk kanë ndryshuar ndjeshëm që nga faza e mëparshme. Si e tillë, matrica e menaxhimit të riskut, bashkëgjatë aneksis B, është një version i përditësuar i atij të mëparshmit. Faza e fundit ka demonstruar se disa forma të riskut, veçanërisht ato që lidhen me rotacionin e drejtuesve të policisë, janë dukshëm më të mundshme dhe më të vështira për t'u menaxhuar nga sa u vlerësua, dhe kështu vlerësimet e tyre janë përshtatur. Po kështu, disa nga risqet e partneritetit nuk kanë ndodhur dhe statusi më i fortë i Programit si partner i PSS-së konsiderohet të jetë në një komplet të reduktuar risqesh.

Përfundim

Dizenjimi i Programit të Fazës së Tretë përqendrohet në konsolidimin e mësimave dhe arritjeve të fazave të mëparshme. Sukseset e fazave të mëparshme dhe partneriteti i fuqishëm që është arritur ndërmjet Programit dhe PSS-së ofrojnë mundësinë që Programi të mbështetet mbi ndryshimet e mëparshme dhe të fokusohet gjithnjë e më shumë mbi aktivitetet për zgjerimin e gamës së rajoneve shqiptare që mbështeten dhe forcimin e njëtrajtshmërisë së zbatimit. Faza e Tretë mund ta përballojë këtë pasi nevoja për mbështetje infrastrukturore dhe zhvillim politikash është reduktuar, për shkak të përpjekjeve të mëparshme të Programit.

Ndërsa objekti aktual i aktivitetit të FPKS-së do të mbeten në çështjet që lidhen me policimin në komunitet, përgjegjshmërinë dhe analizën dhe iniciativat për të reagimet ndaj shqetësimeve specifike të komunitetit, nuk duhet harruar që në mungesë të zhvillimit të burimeve njerëzore në tërësi, mundësitë afatgjata për ndryshime të qëndrueshme do të mbeten të kufizuara. Menaxhimi efektiv dhe transparent i burimeve njerëzore duhet të jetë në qendër të çdo programi reformash institucionale me shtrirje më të gjerë. Në mungesë të strategjive të tilla, institucioni i policisë mund të dobësohet nga transferimet e papërshtatshme ose promovimet e personelit dhe mund të mos jetë në gjendje t'i rezistojë ndikimit të jashtëm në lidhje me këto çështje kritike. Do të jetë vendimtare për Fazën e Tretë që të vlerësojë realisht progresin gjatë zbatimit, duke u përqendruar veçanërisht në atë se cilat janë rezultatet e mundshme të qëndrueshme në bazë të progresit të arritur dhe të vërtetuar.

Siç është përmendur më herët në raport, koordinimi i asistencës ndërkombëtare për sektorët e sigurisë dhe drejtësisë në Shqipëri duhet të përmirësohet në mënyrë që të shmanget mbivendosja e përpjekjeve dhe të arrihet vlera maksimale për paranë e shpenzuar. Departamenti i sapokrijuar ASPSKN i ngarkuar me trajtimin e kësaj çështjeje është një ndërhyrje krejtësisht e arsyeshme dhe e përshtatshme, megjithëse nuk duhet të pengojë anëtarët e komunitetit ndërkombëtar të mbështesin iniciativat e zhvillimit sektorial p.sh. dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje, në përmirësimin e përpjekjeve të tyre të komunikimit dhe koordinimit me partnerët shqiptarë bashkëpunues.

Ekipi i Hartimit të Projektit të Fazës së Tretë vlerëson me mirënjohje kohën, këshillat dhe mbështetjen e ofruar nga shumë individë të intervistuar gjatë tri vizitave së tyre në Shqipëri. Ekipi dëshiron veçanërisht të falënderojë anëtarët e lartë të MB-së dhe PSS-së, që dhanë kaq shumë nga koha e tyre e vlefshme dhe mbështetjen dhe udhëzimet e vazhdueshme të dhëna nga ekipi i Ambasadës Suedeze.

ANEKSI A
KUADRI MONITORUES DHE UDHËZUESI I TREGUESVE

Shtylla e FPKS-së	Rezultati	Llojet e treguesve	Burimet e Mundshme të të Dhënave
1	Oficerë të trajnuar në mënyrë të përshtatshme	Monitorimi i Programit të zbatimit të aftësive që janë mësuar. Integrimi i koncepteve të policimit në komunitet në trajnimin standard të policisë së PSS-së.	Raportet nga vizitat mentoruese/monitoruese nga stafi i Programit në mbështetje të RPL-së.
1	Policimi i Përgjegjshëm në Komunitet	Dëshmi nga Programi piloti se çfarë efekti kanë KVT-të në sjelljen e policisë. Statusi i financimit nga QSH-ja për KVT-të.	Informacioni i anketimit në komunitet mbi ndryshimet në besimin në polici. Buxheti nga Qeveria Shqiptare. Raporte nga vizita mentoruese/monitoruese nga stafi i Programit
1	Drejtimi Mbështetës i Policisë	Prova nga deklaratat publike dhe nga shpërndarja e personelit/burimeve që drejtuesit e policisë po i japin përparësi policimit në komunitet.	Raportimi mediatik i deklaratave të policisë. Strukturat organizative të policisë në çdo RPL.
2	Këshillat Vendorë efektivë për Sigurinë Publike	Takime të rregullta dhe gjithëpërfshirëse të KVSP-të, të cilat rezultojnë në reagimin dhe adresimin e shqetësimeve të komunitetit. # e KVSP-ve që mbledhen të paktën çdo tremujor	Monitorimi i takimeve nga stafi i Programit. Vlerësimi i pikave të veprimit dhe dëshmi se ato janë adresuar nga organizata përkatëse.
2	Sektorët Efektivë për Analizë dhe Monitorim	Krijimi i një njësie qendrore dhe gjykimi i ekipit të Programit se çdo RPL-ë ka krijuar një SAM efektiv dhe të integruar, duke ofruar të dhëna për policimin në komunitet të cilat përdoren nga ajo RPL-ë dhe nga selia qendrore.	Vlerësimi nga EMP-ja për çdo RPL. Përdorimi i të dhënave të marra prej RDL-ve në planifikimin e kryer nga selia qendrore.
3	Përmirësimi i reagimit të parë ndaj Dhunës në Familje	Dëshmi se PSS-ja ka një përgjigje të qëndrueshme ndaj ankesave për dhunën në familje dhe se kjo kontribuon në funksionimin më efektiv të mekanizmit të referimit.	Sondazhet e komunitetit për kënaqësinë me reagimin e policisë.
			Ankesa në lidhje me reagimin e policisë.
3	Ruajtja e aftësisë së Drejtorisë së Qarkullimit rrugor	Buxheti i mirëmbajtjes është mjaftueshëm për pajisjet aktuale; të gjitha pajisjet funksionale dhe në përputhje me ligjin.	Raportimi i Drejtorisë së Qarkullimit Rrugor. Buxheti nga Qeveria Shqiptare.
3	Edukim efektiv shkollor për çështjet e policimit	Rregullsia e kontaktit dhe mbulimi i çështjeve kyçe të policimit në komunitet për fëmijët. Përfshirja/integrimi i demonstruar i personelit të MAS-së dhe OSS-ve, duke treguar integrimin e arsimit dhe policimit	Informacioni i sondazhit në komunitet. Potencialisht MAS-i dëshmon se fëmijët janë më të informuar.

ANEKSI B
MATRICA E MENAXHIMIT TË RISKUT

	Faktori i Riskut	Ndikimi	Probabiliteti	Strategjia e Zbutjes dhe Përgjegjësitë
	Investimi shqiptar dhe pranimi			
1	Riorganizim madhor i partnerëve kryesorë drejtues të policisë: - Ndryshimi i vazhdueshëm në drejtimin e lartë ndikon në pranueshmërinë e koncepteve të reja të policimit; - Ndryshimi në menaxhimin e lartë rezulton në ristrukturime dhe prioritete organizative të rregullta dhe të reja.	E mesme	E lartë	- Në konsultim me drejtorin e përgjithshëm, identifikimi i roleve kryesore si pozicione përfaqësuese ku kërkohet qëndrueshmëri në pozicion për një zbatim të suksesshëm; - Monitorimi i stabilitetit të roleve për të gjithë partnerët kryesorë drejtues të PSS-së dhe raportimi për këtë në KDP-së; - Angazhimi me MB-në dhe MBNJ-në në PSS-ë për zbutjen e këtij risku.
2	Rezistenca e brendshme ndaj reformave: - Drejtuesit e PSS-së nuk arrijnë të mbështesin zbatimin e koncepteve të policimit në komunitet; - Menaxhimi i mesëm nuk adopton, kupton apo përjeton koncepte apo qasje të reja policore.	E mesme	E mesme	- Prezantimi në faza e mbështetjes për RPL-në për të lejuar kohë për t'u angazhuar me menaxhimin e mesëm dhe të lartë të PSS-së; - Mbajtja e raportit të ngushtë me Drejtorin e Përgjithshëm për zbatimin e koncepteve të policimit në komunitet.
3	Komiteti Drejtues i Projektit nuk takohet rregullisht ose nuk ndërmer veprime/vendime: - KDP-ja nuk “drejton” Programin dhe vendimet kryesore nuk merren në kohën e duhur për të siguruar që Programi të mbetet i fokusuar dhe në rrugën e duhur; - Projekti nuk përfshin gamën e plotë të aktorëve kryesorë të qeverisë në menaxhim dhe drejtim.	E mesme	E ulët	- EMP-ja, duke vepruar si Sekretariat (dhe e mbështetur nga MB-ja/PSS-ja, sipas rastit), duhet të marrë një rol aktiv për të siguruar që anëtarët e KDP-së të jenë të përgatitur në mënyrë të përshtatshme për çdo takim dhe dokumentet të qarkullojnë mjaftueshëm paraprakisht për të mundësuar diskutime të informuara; - Procesverbalet e KDP-së tregojnë qartë pikat e veprimit, personat/institucionet përgjegjëse për përmbushjen dhe afatet kohore për përmbushjen; - EMP-ja monitoron angazhimin dhe përfshirjen e vazhdueshme të ministrive të tjera qeveritare; - Raportimi dy-vjetor i progresit të FPKS-së bëhet përmes KDP-së.
4	Programi humb koherencën: - Presioni nga MB/PSS-ja për të ofruar mbështetje për aktivitetet <i>ad hoc</i> jashtë planit të planifikuar; - Ndikimi i Programit zbehet/Programi humb fokusin si rezultat i reagimit ndaj kërkesave të reja/shtesë për aktivitete konkrete nga MB-ja/PSS-ja.	E mesme	E mesme	- Përfshirja e MB-së/PSS-së në procesin e dizenjimit për të siguruar për objektin është rënë dakord dhe se do të ketë mundësi të kufizuara për të ndryshuar fushat pasi të miratohet; - Pëlqimi i KDP-së që kërkohet, përveç atij të Sida-s, për çdo devijim thelbësor ose kërkesë për asistencë të re; - Kërkesat duhet të shoqërohen me një analizë të qartë se si kërkesa e re kontribuon në arrijtjen e rezultateve të drejtpërdrejta të Programit; - EMP-ja duhet të sigurojë që kërkesat për aktivitete të reja të përfshihen në dokumentet përgatitore për KDP-në.
5	Qeveria dështon në menaxhim dhe planifikon inkorporimin dhe mbështetje me programe dhe pajisje të reja të TI-së për policinë të ofruara nga Programi: - Programet e reja/platformat IT nuk lejohen ose nuk lidhen me sistemin IT të QSH-së nga AKSHI; - Pilotimet për pajisje të reja nuk mbështesin asnjë përmirësim të qëndrueshëm në kapacitetin e policisë.	E ulët	E mesme	- PSS-ja dhe MB-ja sigurojnë miratimin paraprak nga AKSHI në lidhje me standardet e kërkuara për programet dhe pajisjet IT të reja përpara blerjes; - Pilotimet për pajisje dhe programe vazhdojnë vetëm pas planifikimit nga Qeveria Shqiptare për mbështetje (mirëmbajtje dhe licenca), siç mbulohet në riskun 8;

Proceset e Programit				
6	Korrupsion ose pretendime për korrupsion në Program (veçanërisht të rëndësishme për Skemën e Grandeve dhe prokurimin e pajisjeve): - Keqpërdorimi i fondeve dhe kontabiliteti i dobët; - Favorizimi i grupeve të veçanta për projekte.	E mesme	E ulët	- FPKS-ja aktuale ka vazhduar praktikatat transparente për SGS-të e tyre, të cilat duhet të vazhdojnë në Programin e ri; - Auditimet financiare; - Procedurë e qartë dhe transparente e përzgjedhjes për të gjitha projektet; - Mbështetja në përvojat e FPKS-së aktuale – dorëzimi i të gjitha dokumenteve të zbatuesit e rinj; - Pretendimet për korrupsion do të ndiqen menjëherë nga EMP-ja dhe Sida/ dhe do të informohet KDP-ja.
7	Ekspertët nuk janë të një cilësie mjaft të lartë.	E mesme	E ulët	- Kontrolli i cilësisë nga Sida/PSS / MB-ja në procesin e përzgjedhjes së tenderit.
	- Anëtarët e personelit të EMP-së nuk kanë kapacitetet për të ofruar cilësinë e kërkuar të punës; - Ekspertët afatshkurtër nuk ofrojnë punë të një cilësie/rëndësie të mjaftueshme për kontekstin shqiptar.			- Përdorimi i mekanizmit të monitorimit për të gjurmuar performancën dhe për të ndjekur reagimet nga përfituesit mbi performancën e ekspertëve; - Terma të qarta të referencës dhe rezultate të pritshme që do të zhvillohen për ekspertët afatshkurtër etj.
Qëndrueshmëria				
8	Qeveria Shqiptare nuk merr përsipër elemente të përgjegjësisë buxhetore: - Projektet pilot dështojnë kur MB-ja/PSS-ja nuk sigurojnë investimin fillestar, ose nuk financojnë zgjerimin e Projektit pilot për të mbuluar të gjithë aftësinë organizative; - Anketat e vendit/rajonit janë të shtrenjta dhe nuk është bërë asnjë marrëveshje për t'i transferuar ato te një organizatë lokale.	E lartë	E mesme	- I gjithë pilotimi i aftësive të reja vazhdon në përputhje me qëllimin e Qeverisë Shqiptare për të investuar dhe me një vlerësim të vlerës në para të aftësisë së fituar; - E gjithë mbështetja e Projektit përfshin mekanizma të qartë për Qeverinë Shqiptare që të miratojë përgjegjësitë e financimit për ruajtjen e aftësive të fituara; - Çdo ndikim buxhetor për procedurat e reja do të duhet të përfshihet në planifikimin buxhetor të MB-së/PSS-së; - Projekti angazhohet me Institutin e Statistikave për të ofruar një rrugë për menaxhimin dhe financimin nga Qeveria Shqiptare; - RAM-i i Programit vlerëson progresin drejt rezultateve të qëndrueshme dhe ri-orienton përpjekjet aty ku nuk arrihet qëndrueshmëria.
8	Projekti nuk është në gjendje të shtrihet në rajone të mjaftueshme për të mbështetur ndryshimin e përgjithshëm të kulturës në PSS: - Afati kohor për zbatimin e suksesshëm në çdo DPL tejkalon kuadrin kohor të Projektit; - Kapaciteti jokonsistent i Qeverisë së Shqipërisë në çdo rajon rezultojnë në dështimin e konceptit në disa rajone.	E mesme	E mesme	- Dëshmi e qëndrueshmërisë së zbatimit në çdo DPL është një pikë qendrore monitoruese e mekanizmit monitorues të EMP-së - Shqetësimet për t'u ngritur në KDP-së; - Procesi i sensibilizimit në të gjithë PSS-në për Programin – veçanërisht në lidhje me progresin që po bëhet, mësimet e nxjerra dhe aktivitetet e shpërndarjes dhe përsëritjes.

ANEKSI C
LISTA E INTERVISTAVE DHE VIZITAT E ZHVILLUARA

Komuniteti Ndërkombëtar

Petra Burcher	Shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim, Ambasada Suedeze
Linda Gjermani	Punonjëse Programi, Qeverisja e Mirë dhe Drejtësia, Ambasada Suedeze
Edlira Papavangjeli	Menaxhere Programi, Programi i Barazisë gjinore, UNDP
Sihana Nebiu	Shefe e Njesisë së demokratizimit, OSBE
Mira Xhamallati	Punonjëse e Menaxhimit të Kufijve Shtetërorë, OSBE
Fabio Ottaviani	Drejtues Ekipi, EULEA
Richard Bone	Drejtues Ekipi, Programi i Zhvillimit i MB-së
Redion Qirjazi	Menaxher Projekti, Reconnecting Albanian Youth & Society (RAYS)
Edval Zolo	Menaxher Projekti, Programi i Perspektivave të Reja
Jan Ake Kjellberg	Policia Kombëtare Suedeze (në lidhje me video)

Qeveria e Shqipërisë

Romina Kuko	Zëvendësministre, Ministria e Punëve të Brendshme
Daniela Cekani	Drejtoreshë, Projektet IPA & Lidhja e Donatorët, Ministria e Punëve të Brendshme
Elkana Himci	Projektet IPA & Lidhja e Donatorët, Ministria e Punëve të Brendshme
Etleva Sheshi	Drejtoreshë, Barazia Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimeve Sociale
Erinda Ballanca	Avokate e Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP)
Ahmet Prenci	Komisar, Mekanizmi Kombëtar i Parandalimit, PAI
Shkelqim Allkaj	Drejtor, Drejtoria e Politikave, Ministria e Arsimit
Albana Çela	Drejtoreshë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Ministria e Arsimit

Policia e Shtetit Shqiptar - Drejtoria Qendrore

Muhamet Rrumbullaku	Drejtor i Përgjithshëm
Redi Jaupi	Drejtor i Lartë, Rendi dhe Siguria Publike
Ferdinand Mara	Drejtues i Parë, Drejtoria e Rendit Publik
Altin Qato	Drejtues i Parë, Drejtoria e Qarkullimit Rrugor
Majlinda Vathi	Specialiste, Sektori i Dhunës në familje
Lindita Lushaku	Specialiste, Sektori i Dhunës në familje
Zenel Hyka	Drejtor i Lartë, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
Janaq Xhelili	Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Logjistike
Zef Laska	Drejtor i Lartë, Shërbimet e Burimeve Njerëzore
Besnik Bakui	Drejtor, Departamenti i Trajnimit

Policia e Shtetit shqiptar - Drejtoria e Tiranës

Tonin Vocaj	Drejtor, Drejtoria e Policisë së Tiranës
Sejfulla Metko	Drejtor Drejtorie, Drejtoria e Policisë së Tiranës
Luigi Vathi	Drejtor Drejtorie, Policia e Rendit, Drejtoria e Policisë së Tiranës
Idriz Dauliz	Shef i Sektorit të Sigurisë Publike, Drejtoria e Policisë së Tiranës
Nëpunës dhe Personel	Salla Operative, Drejtoria e Policisë së Tiranës
Nëpunës dhe Personel	Seksioni i Informacionit Kriminal dhe analizës, Drejtoria e Policisë së Tiranës
Oliver Torba	Komisar, Komisariati Kamzë
Faik Rugo	Shefi i Policimit në Komunitet, Komisariati nr. 2, Tiranë
Edison Visha	Specialist i Policimit në Komunitet, Komisariati nr. 2, Tiranë
Bajram Pasho	Specialist i Policimit në Komunitet, Komisariati nr. 2, Tiranë

Policia e Shtetit shqiptar - Drejtoria e Elbasanit

Ardian Cipa	Drejtor, Drejtoria e Policisë së Elbasanit
	Nëpunës dhe Personel Departamenti i Planifikimit dhe Analizës, Drejtoria e Policisë së Elbasanit

Policia e Shtetit shqiptar - Drejtoria e Durrësit

Skender Hita	Drejtor, Drejtoria e Policisë së Durrësit
Armir Gjikolla	Drejtor, Siguria dhe Rendi
Dritan Allajbej	Shef i Seksionit Urban dhe Interurban
Donald Krali	Shef i Seksionit të Ankesave

Policia e Shtetit shqiptar - Drejtoria e Beratit

Shkelqim Xhezairi	Zëvendësdrejtor, Drejtoria e Policisë së Beratit
Viron Nito	Shef i sektorit të Monitorimit dhe Analizës

Akademia Shqiptare e Sigurisë

Ilirjan Mandro	Prof. dr., rektor/drejtor
----------------	---------------------------

Këshilli Vendor për Sigurinë Publike, Elbasan

Elena Xhina		Shefe e Kabinetit të Zyrës së Kryetarit të Bashkisë
Kreshnik Ajarj		Kryeprokuror, Rrethi Elbasan
Elvis Muco		Koordinator, Shërbimet Shëndetësore dhe Sociale, Elbasan
Katerina Proco		Sekretariati i KVSP-së, Elbasan
Bashkia e Beratit		
Eva Dhima		Drejtor, Drejtoria për Integrimin në BE dhe Projektet
Pirro Xheblat		Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Sociale
Akademia		
Dorina Hoxha		Profesor i Asociuar dhe Dekan, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tiranës
Aurela Anastasi Universiteti i Tiranës		Profesore, Departamenti i së Drejtës Publike, Fakulteti Juridik,
Ervin Karamuco Universiteti i Tiranës		Profesor, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti Juridik,
Ivi Rrokaj Universiteti i Tiranës		Doktor, Departamenti i së Drejtës Penale, Fakulteti Juridik,
OJQ & OSC		
Erinda Ndroqi		Drejtoreshë, Instituti për Aktivizëm & Ndryshim Social
Eldisa Lloshi		Drejtoreshë, Instituti për Ndryshim & Udhëheqje
Brikena Puka		Drejtoreshë, VATRA
Altin Hazizaj		Drejtor, Qendra për të Drejtat e Fëmijës, Shqipëri
Sotiraj Hroni		Drejtor, Instituti për Demokraci & Ndërmjetësim

Ekipi i Menaxhimit të Projektit të FPKS-së

Ansi Shundi	Drejtues Ekipi
Arian Braha	Punonjës Projekti
Jolanda Gugai	Punonjëse Projekti

ANEKSI D

Projektbuxheti në euro

Artikulli	Hollësi / përlogaritje	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Totali
Mbështetje për Policimin në Komunitet	Materiale trajnimi & ofrimi i trajnimit/mentorimit të vazhduar	50'000	50'000	50'000	50'000	50'000	250'000
	Monitorimi i përgjegjshmërisë dhe KVT	20'000	20,000	20,000	20,000	20,000	100'000
	Mbështetje për drejtimin e policisë	25'000	25'000	25'000	25'000	25'000	125'000
Analizë dhe Përgjegjshmëri	Mbështetje për KJSP-të	40'000	40'000	40'000	40'000	30,000	190'000
	Mbështetje për Sektorët e Analizës dhe Monitorimit	20'000	20'000	20'000	20'000	20,000	100'000
	Anketat në Komunitet	30'000	30'000	30'000	30'000	30,000	150'000
Aftësitë e Specializuara të Policisë	Përmirësimi i ndihmës së parë për viktimat e dhunës në familje	25'000	25'000	25'000	25'000	25'000	125'000
	Policimi Efektiv i Qarkullimit Rrugor	25'000	25'000	25'000	25'000	25'000	125'000
	Ndërgjegjësimi i të Rinjve në shkollë	30'000	30'000	30'000	30'000	30'000	150'000
Skema e Grandeve	Fondi i grandeve (deri në 10 000 euro)	120'000	120'000	120'000	120'000	120'000	600'000

	Menaxheri i Skemes së Grandeve	4'000	4'000	4'000	4'000	4'000	20'000
	Materiale publicistike, udhëtime, etj., dhe	50'000	50'000	50'000	50'000	50'000	250'000
Menaxher Lokal i Programit	Kohë e plotë gjatë kohezgjatjes, duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit	45'000	45'000	45'000	45'000	45'000	225'000
Eksperti Ndërkombëtar i policisë	Kohë e pjesëshme 50% - përfshin të gjitha dietat	35'000	17'500	17'500	17'500	17'500	105'000
Ekspert lokal M&E	Përfshin shpenzimet e udhëtimit; fitet e para me kohë të plotë, në vijim me kohë të pjesëshme	25' 000	25'000	25'000	25'000	25'000	125'000
Personeli mbështetës (2)	Përfshin bashkërendimin dhe administrimin	44'000	44'000	44'000	44'000	44'000	220'000
Shpenzimet e zyrës	Përfshin qeranë, internetin, mirëmbajtjen e faqes së internetit, energjinë elektrike, ujin, telefonin, kancelaritet, printimin, pastrimin etj	20'000	20'000	20'000	20'000	20,000	100'000
Përkthimi		5'000	5'000	5'000	5'000	5,000	25'000
Inspektimet dhe auditimi i jashtëm		12'000	12'000	92'000	12'000	12'000	140'000
Totali							3'125'000